



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 23

2001

Maj

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 8768 datë 19.4.2001	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Dioqezës në Rrëshen dhe Karitasit Shqiptar për ngritjen dhe funksionimin e shkollës së mesme profesionale “Shën Jozefi Punëtor””.....	669
Ligj nr. 8769 datë 19.4.2001	Për ratifikimin e “Konventës financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale, Itali për shumën 12.713.114.625 lira italiane për financimin e rehabilitimit të rrugës Tapizë-Fushë Krujë, si dhe për urat e Matit dhe të Drinit, në kuadër të programit “Rrugët Kombëtare”.....	672
Ligj nr. 8770 datë 19.4.2001	Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike.....	684
Ligj nr. 8771 datë 19.4.2001	Për kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë.....	689

Ligj nr. 8772 datë 19.4.2001	Për ruajtjen dhe kontrollin e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë.....	691
Ligj nr. 8773 datë 23.4.2001	Për tubimet.....	701
Ligj nr. 8774 datë 23.4.2001	Për ratifikimin e “Konventës nr.182 “Format më të këqia të punës së fëmijëve, 1999” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës”.....	708
Ligj nr. 8775 datë 23.4.2001	Për ratifikimin e “Konventës nr.131, datë 6.6.1970 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Caktimi i pagës minimale””.....	712
Vendim i KM nr.245, datë 20.4.2001	Për disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin 418, datë 10.6.1996 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e normave të veshmbathjes së ushtarakëve, të strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes”.....	715
Vendim i KM nr.277, datë 8.5.2001	Për dhënie fond ndihme Partisë Demokratë.....	727
Udhëzim i KQZ nr.34, datë 12.5.2001	Për regjistrimin e zgjedhësve në Forcat e Armatosura dhe në Forcat e Rendit.....	727

L I G J
Nr.8768, datë 19.4.2001

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DIOQEZËS NË RRËSHEN DHE KARITASIT SHQIPTAR PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE “SHËN JOZEFI PUNËTOR””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Dioqezës në Rrëshen dhe Karitasit Shqiptar për ngritjen dhe funksionimin e shkollës së mesme profesionale “Shën Jozefi Punëtor””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2991, datë 4.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Rexhep Meidani

MARRËVESHJE
PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E SHKOLLËS
SË MESME PROFESIONALE "SHËN JOZEFI PUNËTOR" NË RRËSHEN, MIRDITË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Dioqeza në Rrëshen,
Karitasi Shqiptar

Duke patur parasysh se, si rezultat i kushteve të tranzicionit në të cilin ndodhet Shqipëria, janë evidentuar një sërë problemesh sociale (varfëria, papunësia, largimi nga vendi) që kanë përfshirë kryesisht të rinjtë dhe që kërkojnë një ndërhyrje për zbutjen dhe parandalimin e tyre;

Duke patur parasysh se ekziston një masë e konsiderueshme të rinjsh të cilët kanë nevojë për ndihmë edukative, profesionale, shoqërore;

Duke patur parasysh faktin se qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është që t'u ofrojë atyre ndihmë shkollimi për t'i aftësuar profesionalisht, nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të një shkolle, e cila jep mundësi për përgatitjen e tyre dhe të një konvikti për të favorizuar ata që vijnë nga zonat e thella e më të varfëra;

Duke patur parasysh se në Dioqenëza e Rrëshenit, e cila përfshin rrethet Mirditë, Mat, Bulqizë, Dibër nuk ekzistojnë shkolla të tilla profesionale;

Duke patur parasysh se kontaktet me përfaqësues të ndryshëm të qeverisë miratojnë ngritjen e një shkolle të tillë, palët nënshkruese janë dakord të lidhin një marrëveshje si më poshtë:

1. Objekti i Marrëveshjes

- Bashkëpunimi në fushën e edukimit profesional, i cili konsiston në ngritjen dhe funksionimin e shkollës profesionale dhe të konviktit për t'u përgjigjur disa problemeve emergjente të kohës për kategoritë e mëposhtme:

- a) të rinjtë adoleshentë nga mosha 14-18 vjeç;
- b) të rejtat nga mosha 14-18 vjeç.
- 2. Kohëzgjatja e marrëveshjes.
 - Marrëveshja do të vazhdojë për periudhën e nevojshme të ndërtimit të shkollës dhe pajisjes, deri në fillimin e aktivitetit mësimor në marrëveshje.
 - Ky afat mund të ndryshojë mes palëve.
- 3. Qëllimi i Marrëveshjes
 - Qëllimet e veprimtarisë së Karitasit Shqiptar dhe të Dioqezës në Rrëshen për këtë Marrëveshje janë humanitare dhe jofitimprurëse.
 - Qëllimet e saj janë të bazuara në shqetësimin për të rinjtë dhe në kujdesin nëpërmjet programeve mësimore të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me Dioqezën, duke respektuar liritë ideologjike dhe besimet fetare, në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe dokumentet e të drejtave të njeriut.
- 4. Financimi
 - Projekti, mbi bazën e të cilit nënshkruhet Marrëveshja, financohet plotësisht nga shoqata bamirëse ndërkombëtare, në favor të Dioqezës së Rrëshenit, e cila ka një vlerë prej tre miliardë liretash (përfshirë TVSH-në).
- 5. Palët nënshkruese të marrëveshjes
 - Këshilli i Ministrive të Republikës së Shqipërisë;
 - Dioqeza Rrëshen, me seli në Rrëshen, rruga "Shën Vinçenzo de Paoli", përfaqësuar nga administratori apostolik i saj Mons. Cristoforo Palmieri;
 - Karitasi Shqiptar, shoqatë joqeveritare, fetare e bamirëse, pa qëllime përfitimi ekonomik, me adresë rruga "Don Bosko", Tiranë, regjistruar si person juridik me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Tiranë me nr. 6415, datë 16.10.1995, përfaqësuar nga Don Nikë Pace.
- 6. Dioqeza Rrëshen merr përsipër:
 - Të verë në jetë programin sipas linjave operative, të përligjura në dokumentin e projektit bashkëngjitur.
 - Të gjejë vend ndërtimi të përshtatshëm për ngritjen e shkollës dhe të blejë tokën me fondet e saj.
 - Të zbatojë legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.
 - Brenda territorit të blerë, të zhvillojë, në strukturën e vet, ndërtesa dhe terrene (sipas projektit) dhe aktivitete mësimore me vetëfinancim, të cilat nuk do të kenë qëllim fitimi.
 - Të garantojë deri në realizimin e projektit mbulimin dhe shpenzimet e veta, për ngritjen dhe funksionimin e shkollës, pagat e personelit, duke përfshirë në to sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.
 - Të bëjë seleksionimin e kandidatëve për në shkollë, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara për zbatimin e programit nga ana e kandidatit dhe dispozitat ligjore në fuqi.
 - Të bëjë seleksionimin e operatorëve shqiptarë për pjesëmarrjen e kërkuesit, në bazë të principeve që frymëzojnë Dioqezën, si gatishmëria për shërbim, përgatitja e lartë profesionale, vullnetarizimi etj.
 - Të sigurojë në shkollë shërbime dhe mësimdhënie që të jenë të paktën në të njëjtin nivel me ato të siguruar nga institucionet shtetërore.
 - Të sigurojë në konvikte ushqime të garantuara dhe normativat e shpërndarjes të jenë sipas kriterëve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.
 - Të sigurojë në shkollë dhe konvikte kushte higjieno-sanitare dhe mjekësore, në përputhje me kriteret e vendosura nga Ministria e Shëndetësisë.
 - Të aktivizojë çdo formë financimi të mundshëm në nivel kombëtar, ndërkombëtar, si dhe të vetëfinancimit, si kusht financiar për realizimin e projektit.
- 7. Karitasi Shqiptar merr përsipër:
 - T'i besojë Dioqezës të gjitha përgjegjësitë për zhvillimin e aspekteve strukturore, teknike, profesionale, mësimore dhe të drejtimit të projektit bashkëngjitur dhe të jetë garant për realizimin e tij.
 - Të respektojë legjislacionin shqiptar.

8. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë merr përsipër:

- Të lehtësojë procedurat e licencimit, lejet e zakonshme dhe autorizimeve për vënien në jetë dhe përfundimin sa më të mirë të projektit.

- Të përjashtojë të gjitha aktivitetet e Dioqezës dhe Karitasit të cilat janë të lidhura me projektin dhe programin e shkollës së mesme profesionale nga të gjitha taksat doganore dhe administrative, duke përfshirë edhe TVSH-në.

- Të ndihmojë për furnizimin me ujë, energji elektrike, gazi (në masën që bëhet furnizimi i popullatës së vendit), për kanalizimet, linjën telefonike, si dhe shërbime të tjera, që mund të nevojiten për ngritjen dhe funksionimin e shkollës.

- Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë cakton Ministrin e Arsimit dhe Shkencës për të ndjekur zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

9. Mbarimi i Marrëveshjes.

- Kjo Marrëveshje përfundon:

- me mbarimin e afatit të përcaktuar në Marrëveshje;

- kur shkelen detyrimet e palëve dhe dispozitat e kësaj Marrëveshjeje;

- kur nga palët konstatohet largim nga objekti dhe qëllimi i Marrëveshjes.

- Në përfundim të Marrëveshjes nëse ajo nuk do të rinovohet, godina dhe të gjitha pajisjet i mbeten Dioqezës së Rrëshenit.

10. Pika e diskutimit

- Kur palët kanë mosmarrëveshje midis tyre, krijohet një komision i përbashkët tripalësh me përfaqësues nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Dioqeza Rrëshen dhe Karitasi Shqiptar, të cilët brenda dy muajve, do të zgjidhin mosmarrëveshjen, nëpërmjet bisedimeve dhe frymës së mirëkuptimit.

11. Dokumentet shoqëruese të Marrëveshjes janë:

- statuti i shoqatës së Karitasit;

- vendimi i regjistrimit në gjykatë të shoqatës Caritas.

- akti i themelimit të shoqatës Caritas;

- historiku i veprimtarisë së shoqatës Caritas;

- projekti për shkollën e mesme profesionale;

- kërkesa zyrtare për ushtrim aktiviteti;

- dokumenti për vërtetësimin e pronës mbi tokën;

- garancia bankare e Dioqezës së Rrëshenit.

12. Data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes

- Marrëveshjen, pasi e lexuan, palët e gjetën konform ligjit dhe me vullnetin e tyre të plotë e nënshkruan sot më datë 14.2.2001, Tiranë.

- Marrëveshja është hartuar në gjuhën shqipe në pesë kopje origjinale.

- Kjo Marrëveshje nënshkruhet nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Dioqeza e Rrëshenit, Karitasi Shqiptar dhe hyn në fuqi pasi të verifikohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë	Vendi /Data
Ethem Ruka	14.2.2001

Mons. Crisoforo Palmieri	Vendi /Data
Administratori Apostolik	14.2.2001

KARITASI SHQIPTAR	Vendi /Data
Mons. Rrok Mirdita	14.2.2001

L I G J
Nr.8769, datë 19.4.2001

**PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS FINANCIARE NDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE MEDIOCREDITO CENTRALE, ITALI PËR
SHUMËN 12.713.114.625 LIRA ITALIANE PËR FINANCIMIN E REHABILITIMIT TË
RRUGËS TAPIZË-FUSHË KRUIJË, SI DHE PËR URAT E MATIT DHE TË DRINIT, NË
KUADËR TË PROGRAMIT “RRUGËT KOMBËTARE””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :**

Neni 1

Ratifikohet “Konventa financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale, Itali për shumën 12.713.114.625 lira italiane për financimin e rehabilitimit të rrugës Tapizë-Fushë Krujë, si dhe për urat e Matit dhe të Drinit, në kuadër të programit “Rrugët Kombëtare””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2992, datë 4.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Rexhep Meidani**

**KONVENTË
FINANCIARE MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MEDIOCREDITO
CENTRALE S.P.A**

Lidhur në bazë të Nenit 6 të ligjit italian nr.49, datë 26 shkurt 1987, midis:

Qeveria e Republikës së Shqipërisë, me seli në Tiranë (me cilësinë e Huamarrësit), agjent në emër dhe për llogari të Qeverisë Shqiptare, e cila përfaqësohet nga Dr.Anastas Angjeli nga njera anë

dhe

Mediocredito Centrale SPA, Shoqëri Aksionere e Grupit Bancaroma, e regjistruar në Regjistrin e Bankave, me kapital social 950.277,270.000, me seli në Via Piemonte 51-00187 Romë, regjistruar në regjistrin tregtar me nr.3362/94, PIVA 00915101000, Kodi Fiskal nr.00594040586 (i cili në këtë Konventë do të njihet si Mediocredito Centrale), me cilësinë e administratorit të Fondit të krijuar në bazë të Nenit 6 të ligjit italian nr.49, datë 26 shkurt 1987, përfaqësuar nga në Dr Dr.Francesco Anania në Dr.....

nga ana tjetër

Duke pasur parasysh që

Ministria e Thesarit të Qeverisë së Republikës Italiane, me propozim të Ministrisë së Punëve të Jashtme, me dekretin nr.203954, datë 18 dhjetor 2000, ka autorizuar Mediocredito Centrale t'i japë Qeverisë së Republikës së Shqipërisë një kredi financiare prej 12 713 114 625 (dymbëdhjetë miliardë shtatëqind e trembëdhjetë, njëqind e katërbëdhjetë, mijë gjashtëqind e njëzet e pesë), lireta, me këto kushte:

- Kthimi: në 24 (njëzet e katër) këste gjashtëmujore të barabarta dhe të njëpasnjëshme, ku afati i pagimit të këstit të parë mbaron 330 (treqind e tridhjetë) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente financiare;

- Përqindja e interesit: 0.25% (zero presje njëzet e pesë) interes nominal vjetor, i cili do të paguhet në fund të gjashtëmujorit ku ky gjashtëmujor fillon nga data e çdo përdorimi.

- Destinacioni: Financimi i të mirave dhe shërbimeve me origjinë italiane për realizimin e pjesës rrugore Tapizë-Fushë-Krujë dhe e dy urave;

- Valuta e lëvritit të kredisë: kredia do të lëvrohet në lireta italiane.

Palët bien dakort përsa vijon, duke i konsideruar Hyrjen edhe Aneksat si pjesë përbërëse të kësaj Konvente:

Neni 1 Përkufizime

Në kuadër të kësaj Konvente Financiare dhe të anekseve bashkëlidhur, terminologjia e përdorur do të ketë këtë kuptim:

- “Banka Agjente” është banka me Filialin në Romë, e caktuar nga Huamarrësi siç është parashikuar në Aneksat A) dhe C) dhe pranë së cilës do të hapet në emër të vetë Huamarrësit një llogari rrjedhëse (e quajtur “Llogari me Jashtë”) për akreditimin e fondeve të nevojshme për kryerjen e pagesave të parashikuara në kontratat tregtare.

- “Kontrata/t Tregtare” është/janë kontrata/t e furnizimit të të mirave dhe/ ose shërbimeve nga ana e eksportuesve italiane për importuesit shqiptarë, që lidhen me realizimin e Projekt/Programave

- “Autoritetet Kompetente Italiane” janë Ministria e Punëve të Jashtme (Organi Kompetent i Kooperacionit: Drejtoria e Përgjithshme e Kooperimit për Zhvillim, Komiteti Drejtues etj...) dhe/ ose Ministria e Thesarit dhe/ ose ente të tjera italiane që i parashikon ligji.

- “Konventë financiare” është kjo Konventë Financiare, Hyrja së bashku me Aneksat të cilat janë pjesë përbërëse e saj.

- “Kredi financiare” është financimi që Mediocredito Centrale, në bazë të Autorizimit të dhënë nga Ministria e Thesarit, me propozim të Ministrisë së Punëve të Jashtme, jep sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në Hyrje dhe në Nenin 2 të kësaj Konvente Financiare.

- “Deklarata e borxhit” është deklarata, e cilësuar në Nenin 8, me të cilën Huamarrësi merr detyrimin karshi Mediocredito Centrale për të kthyer kuotat kapital dhe intersat e kësaj Kredie Financiare.

- “Dokumentacioni kontraktual” është dokumentacioni i parashikuar në Kontratën Tregtare dhe që përfshin mënyrat e pagesës (p.sh. faturat, packing list, gjendjen e ecurisë etj...).

- “Periudha e qetësisë” është periudha e cila fillon nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente Financiare dhe përfundon 330 (treqind e tridhjetë) muaj nga kjo datë, siç është përcaktuar në Hyrje.

- “Projekt /Programi” është projekti relativ për realizimin e pjesës rrugore Tapizë-Fushë Krujë dhe e dy urave, i financuar në një pjesë nga Kredia Financiare.

Neni 2 Kredia financiare

2.1 Mediocredito Centrale i jep Huamarrësit, i cili nga ana e tij e pranon një kredi financiare në vlerën 12.713.114.625 (dymbëdhjetë miliardë e shtatëqind e trembëdhjetë e njëqind e katërbëdhjetë e gjashtëqind e njëzet e pesë) lireta.

2.2. Kjo kredi do të financojë Kontratat Tregtare në lidhje me financimin e të mirave dhe shërbimeve me origjinë italiane, për realizimin e pjesës rrugore Tapizë-Fushë Krujë dhe të dy urave.

2.3 Përqinda e përcaktuar për shpenzimeve vendore dhe/ose PVS: 28% e importit total të kredisë financiare.

2.4 Biet dakort që Banka Agjente në lidhje me këtë Kredi Financiare do të jetë Filiali i (Romës) i.....

2.5 Kredia financiare jepet paralelisht me financimin e Bankës Botërore. Kështu Kontrata/t Tregtare relative të Projektit për të cilin në nenin 2.2 do të gjykohen sipas procedurave të tenderave të Bankës Botërore, duke pasur parasysh specifikat e kredisë ndihmë italiane.

2.6 Kredia financiare do të jetë e disponueshme dhe e përdorshme në kohën, mënyrën dhe sipas kushteve të parashikuara në këtë Konventë Financiare, duke pasur parasysh dispozitat (rregullat) në fuqi të Autoriteteve kompetente italiane.

Neni 3

Hyrja në fuqi e Konventës financiare

3.1 Që kjo Konventë të hyjë në fuqi, Mediocredito Centrale duhet të marrë nga Huamarrësi dokumentet e mëposhtëm:

i) Deklaratën e lëshuar nga organi kompetent i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, e cila vërteton caktimin e Huamarrësit për të nënshkruar në emër dhe për llogari të Qeverisë Shqiptare, këtë Konventë Financiare nëpërmjet një personi të autorizuar, konform dispozitave legjislative administrative dhe rregulloreve që janë në fuqi në Shqipëri.

ii) Aktin e caktimit, të lëshuar nga Huamarrësi, të personit ose personave të autorizuar për të firmosur Njohjen e Borxhit (Aneksi E) që parashikohet në Nenin 9 dhe dokumentet e tjera të parashikuara në këtë Konventë, të cilat i bashkangjiten në faksimile (Aneksat A, B dhe C); ky akt duhet të japë në hollësi emrin dhe profesionin e këtyre personave dhe të shoqërohet nga “depozitimi” i firmave të tyre; Huamarrësi duhet t’ia dorëzojë këtë akt, “depozitimin” e firmave, si dhe ndryshimet eventuale edhe Bankës Agjente.

iii) Kopje të mandatit, dhënë Bankës Agjente, për të hapur në emër të Huamarrësit një “Llogari me Jashtë” dhe për t’i përdorur fondet e akredituara ekskluzivisht për të kryer pagesat e përcaktuara nga vetë Huamarrësi dhe, sipas mënyrave të përcaktuara po nga ai, “ky mandat duhet të hartohet në përputhje me Aneksin A, duhet të pranohet shprehimisht nga Banka Agjente dhe po kjo e fundit t’ia konfirmojë me shkrim Huamarrësit dhe për dijëni Mediocredito Centrale.

3.2 Mediocredito Centrale, me marrjen e dokumenteve të përmendura më lart dhe pasi i ka gjetur ato konform kërkesave të tij, i bën të ditur Huamarrësit, Bankës Agjente, me anë të një letre ose telex-it i cili duhet të konfirmohet më pas me letër, datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

Neni 4

Afati i përdorimit të Kredisë

4.1 Afati i përdorimit të Kredisë financiare është 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente financiare. Ky afat mund të zgjatet nga ana Mediocredito Centrale, por jo përtej Periudhës së Qetësisë, me përjashtim të një komunikimi të kundërt nga ana e Huamarrësit, i cili duhet të paraqitet brenda një muaji nga mbarimi i afatit.

4.2 Në rast se afati i përdorimit ka përfunduar dhe nuk është zgjatur, Mediocredito Centrale, pasi ka marrë mendimin e Autoriteteve Kompetente Italiane, i bën të ditur Huamarrësit anulimin e detyrimit, lidhur me fondet e papërdorura.

Neni 5

Mënyrat e përdorimit të Kredisë financiare

5.1 Kredia financiare do të përdoret nga Huamarrësi në rast se do të përmbushen kushtet e mëposhtme:

i) Dhënia e së drejtës nga ana e Mediocredito Centrale e së drejtës nga ana e Autoriteteve Kompetente Italiane, lidhur me përfshirjen e Kontratave Tregtare në Kreditin Financiare;

ii) Rezultati pozitiv i vëzhgimit në kompetencë të Mediocredito Centrale, siç parashikohet në Nenin 5.2 (i).

iii) Marrja nga ana e Mediocredito Centrale e kërkesës për vënien në dispozicion të fondeve dhe të letrës udhëzuese Bankës Agjente, siç parashikohet në Nenin 6.1 dhe 6.2;

5.2 Në vijim të marrjes së të drejtës, siç parashikohet në pikën 5.1 (i), Mediocredito Centrale do të parashikojë kontestualisht:

i) Pajisja e Mediocredito Centrale me lejen e lëshuar nga Autoritete Kompetente Italiane, lidhur me përfshirjen e Kontratave Tregtare në Kredinë Financiare.

ii) Rezultati pozitiv i vëzhgimit në kompetencë të Mediocredito Centrale, siç parashikohet në Nenin 5.2.

iii) Marrja nga ana e Mediocredito Centrale e kërkesës për vënien në dispozicion të fondeve dhe të letrës udhëzuese Bankës Agjente, siç parashikohet në Nenin 6.1 dhe 6.2

5.3 Përfundimi pozitiv i kësaj faze vëzhguese të Mediocredito Centrale do të bëjë të mundur përfshirjen e Kontratave Tregtare në Kredinë Financiare. Kontratat e mësipërme Tregtare do të përsosjen vetëm pas marrjes së kërkesës dhe të letrës, siç parashikohet në Nenin 5.1 (iii).

5.4 Mediocredito Centrale do të verë në dijeni Huamarrësin, Bankën Agjente dhe eksportuesin italian, lidhur me përfshirjen dhe përsosjen financiare të Kontratave Tregtare.

Neni 6

Kërkesa për akreditim fondesh

6.1 Menjëherë pas komunikimit të Mediocredito Centrale për marrjen e lejes siç parashikohet në Nenin 5.2 (ii), Huamarrësi do t'i dërgojë Mediocredito Centrale një kërkesë për vënien në dispozicion të fondeve të nevojshme për të përballuar pagesat e parashikuara në çdonjerën nga Kontratat Furnizuese. Me anën e kësaj Kërkesë, e cila hartohet në përputhje me Aneksin B), Huamarrësi njuh mundësinë e financimit dhe rregullsinë e Kontratave Tregtare dhe angazhohet t'i kthejë Mediocredito Centrale shumën që do të akordohet.

6.2 Huamarrësi do t'i dërgojë Bankës Agjente, për secilën nga Kontratat e mësipërme Tregtare, një letër udhëzuese hartuar në përputhje me Aneksin C), e cila duhet të pranohet shprehimisht nga Banka Agjente, e cila duhet t'ia komunikojë me shkrim Huamarrësit dhe, për dijeni, Mediocredito Centrale.

6.3 Kërkesa dhe letra udhëzuese, që parashikohen në Nenin 6.1 dhe 6.2 të kësaj Konvente, duhet të mbërrijnë në kohën e duhur, por gjithësesi jo më vonë se 6(gjashtë) muaj nga data e njoftimit të Mediocredito Centrale i parashikuar në nenin 5.2 (ii). Me t'u kaluar ky afat, Mediocredito Centrale do të shqyrtojë, duke marrë edhe mendimin e Autoriteteve Kompetente Italiane, shfuqizimin eventual të Kontratave Tregtare si zë i Kredisë Financiare.

6.4 Në bazë të udhëzimeve të marra nga Huamarrësi, siç parashikohen në Nenin 6.2, Banka Agjente do t'i kërkojë herë pas here Mediocredito Centrale, akreditimin në Llogarinë me Jashtë të fondeve të nevojshme për të kryer pagesat e parashikuara në Kontratat Tregtare, sipas modaliteteve të parashikuara në Nenin 7. Banka Agjente do të hartojë kërkesat e akreditimit, konform Aneksit D dhe do t'i dërgojë kopje Huamarrësit.

Neni 7

Mënyrat e akreditimit të fondeve

7.1 Duke qenë gjithnjë në fuqi afati i Kredisë Financiare i parashikuar në Nenin 4.1, secila kërkesë e pjeshme ose e plotë akreditimi (Neni 6.4) duhet t'i mbërrijë Mediocredito Centrale brenda dhe jo më shumë se 24 muaj nga komunikimi, siç parashikohet në Nenin 5.4, lidhur me përsosjen financiare të Kontratave Tregtare ose brenda afatit maksimal që parashikohet në vetë Kontratat. Mediocredito Centrale do të vlerësojë, duke patur parasysh mendimin e Autoriteteve Kompetente Italiane, fshirjen e mundshme të importeve të papërdorshme relative me vetë Kontratën Tregtare.

7.2 Secila nga kërkesat e akreditimit që parashikohet në Nenin 6.4 duhet të paraqitet në përputhje me çdo pagesë që duhet kryer, sipas mënyrave të parashikuara në secilën Kontratë Tregtare, me paraqitjen e Dokumentacionit Kontraktor.

7.3 Dokumentacioni Kontraktor do t'i dorëzohet Bankës Agjene, e cila ia nis fotokopjet e njesuara me origjinalin Mediocredito Centrale dhe origjinalet Huamarrësit.

7.4 Me marrjen e çdo kërkesë të akreditimit, Mediocredito Centrale do të procedojë për verifikimin e Dokumentacionit Kontraktor. Ky verifikim do t'i përkasë Dokumentacionit Kontraktual dhe Kontratave furnizuese përkatëse.

7.5 Mediocredito Centrale do të verë në zbatim kërkesat e lartpërmendura të akreditimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve, nga data e marrjes së tyre.

7.6 Kohët e fundit pas marrjes së çdonjerës nga kërkesat e akreditos, Mediocredito Centrale do të procedojë me verifikimin e Dokumentacionit Kontraktual. Ky verifikim i përket përputhjes me këtë Dokumentacion Kontraktual të Kontratës Tregtare përkatëse.

7.7 Mediocredito Centrale do t'i ekzekutojë kërkesat e mësipërme të akreditimit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së tyre.

7.8 Në varësi të përfundimit pozitiv të verifikimit që parashikohet në Nenin 7.4, Mediocredito Centrale do t'i japë Bankës Agjente udhëzimet e nevojshme për akreditimin e fondeve në Llogarinë me Jashtë dhe do t'i konfirmojë me telex ose fax Huamarrësit shumën totale dhe monedhën e akreditimit.

7.9 Në të njëjtën kohë me akreditimin në Llogarinë me Jashtë, banka Agjente do t'u kryejë pagesat eksportuesve italianë sipas udhëzimeve të dhëna, duke marrë Deklaratën e pagesës që parashikohet në Aneksin F) në dy kopje origjinale, një nga të cilat do t'i dërgohet Huamarrësit dhe tjetra Mediocredito Centrale .

7.10 Pas çdo akreditimi fondesh në Llogarinë me Jashtë dhe kryerjen e pagesave përkatëse eksportuesve të mësipërm, Mediocredito Centrale do i dërgojë me letër Huamarrësit dhe Bankës Agjente për dijeni, planin e shlyerjes së shumës së akodruar me përcaktim të mbarimit të afateve përkatëse siç është parashikuar në Nenin 8. Huamarrësi do të konfirmojë me shkrim pranimin e këtij plani shlyerjeje.

Neni 8

Kthimi i kredisë dhe pagimi i interesave

8.1 Çdo shumë e akredituar në "Llogarinë me Jashtë" do të kthehet në bazë të një plani shlyerje prej 24 (njëzet e katër) këstesh gjashtëmujore, të barabartë dhe të njëpasnjëshme (kuota kapitali), ku pagesa e këstit të parë skadon 330 (treqind e tridhjetë) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente Financiare. Mediocredito Centrale do t'i dërgojë planin e shlyerjes Huamarrësit dhe Bankës Agjente për dijeni, siç është parashikuar në Nenin 7.8.

8.2 Mbi kuotat kapital (këstet) të çdo kreditimi, do të llogariten interesa në masën 0.25% (zero presje njëzet e pesë përqind) në vit, të barabarta me 0.125% (zero presje njëqind e njëzet e pesë përqind) në fund të gjashtëmujorit, duke filluar nga data e kreditimit dhe deri në datën e kthimit të kuotës së fundit të kapitalit. Interesat do të llogariten në bazë muaji 30 (tridhjetë) ditësh dhe viti 360 (treqind e gjashtëdhjetë) ditësh (360/360).

8.3 Gjatë periudhës së kthimit, këto interesa do të paguhet në të njëjtën datë skadence me Kuotat kapital. Gjatë periudhës së aktivitetit zero (Periudhës së Qetësisë), këto interesa do të paguhet në bazë gjashtëmujorit në datat që u korrespondojnë me ditë dhe muaj datave të pagmit të Kuotave të kapitalit. Në këtë mënyrë, kuota e parë e interesit mund të përkojë me një periudhë më të shkurtër se gjashtëmujori. Megjithatë, në rast se kjo periudhë është më e shkurtër se 30 (tridhjetë) ditë, kjo kuotë interesi do të paguhet me kuotën e mëpasshme të interesit. Kuota e parë e interesit, që i përket një periudhe më të gjatë ose më të shkurtër se gjashtëmujori, do të llogaritet për ditët që efektivisht kanë kaluar nga data e akreditimit në "Llogarinë me Jashtë" në datën e pagesës, në bazë të një gjashtëmujori prej 180 ditësh.

8.4 Deri në datën e këshilit të Njohjes së Borxhit (Neni 9), pagesa e interesave që lidhen me çdo përdorim do të bëhet në afatet e parashikuara në planet e shlyerjes (Neni 7.8), menjëherë pas kësaj date kthimi i kapitalit dhe kthimi i kapitalit dhe pagimi i interesave do të bëhen në afatet e parashikuara në planin e shlyerjes të Njohjes së mësipërme të Borxhit.

8.5 Për të gjitha shlyerjet dhe pagesat që duhet të bëhen në bazë të kësaj Konvente

Financiare dhe në bazë të Deklaratës përkatëse të Borxhit, Huamarësi ka detyrimin të bëjë në kohën e duhur akreditimin e shumës përkatëse në lireta italiane, në favor të Mediocredito Centrale ose të ngarkuarve të saj pranë Bankës Agjente. Këto shuma do të akreditoohen pa asnjë zbritje të detyrimeve bankare dhe/ose valutore dhe fiskale dhe pa qenë nevoja e paralajmërimit nga ana e Mediocredito Centrale ose të ngarkuarve të saj.

Neni 9

Lëshimi i Deklaratës së Njohjes së Borxhit

9.1 Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga afati i fundit për përdorimin e kredisë (Neni 4.1), Huamarrësi do t'i lëshojë Mediocredito Centrale Deklaratën e Njohjes së Borxhit, të firmosur në çdo faqe, të hartuar në përputhje me Aneksin E).

9.2 Kjo Deklaratë e Njohjes së Borxhit është lirisht e transferueshme nga Mediocredito Centrale tek personat juridikë publikë ose privatë, italianë apo të huaj. Është e qartë se Huamarrësit nuk mund t'i ngarkohen detyrimet për shpenzimet, komisionet, taksat ose tatimet që mund të rrjedhin nga lëshimi eventual i Deklaratës së Njohjes së Borxhit.

9.3 Plani i shlyerjes së kësteve, i risjellë në Deklaratën e Njohjes së Borxhit do të hartohen duke mbledhur kuotat kapital dhe interesat që nuk u ka mbaruar ende afati dhe këstet që mund t'u ketë kaluar afati por që nuk janë paguar në datën e lëshimit të Deklaratës së Njohjes së Borxhit, të cilat rezultojnë nga planet e veçanta të shlyerjes të përgatitura për çdo përdorim, siç është parashikuar në Nenin 7.8.

9.4 Mediocredito Centrale do të depozitojë Deklaratën e Njohjes së Borxhit për ruajtje dhe administrim pranë Bankës Agjente, pas aprovimit të xhimit në favor të saj.

9.5 Banka Agjente do të regjistrojë herë pas here në Deklaratën e Njohjes së Borxhit pagesat e shumave të kapitaleve dhe interesave dhe këstet që u ka kaluar afati dhe që nuk janë paguar. Me t'u kryer të gjitha pagesat e parashikuara në Deklaratën e Njohjes së Borxhit, Banka Agjente duhej t'ia kthejë këtë të fundit Huamarrësit, kundrejt mandatit përkatës.

Neni 10

Detyrimet e Huamarrësit

10.1 Angazhimi i Huamarrësit për të kryer pagesën e shumave në bazë të kësaj Konvente Financiare dhe Deklaratës relative të Njohjes së Borxhit është autonom, absolut, i pakushtëzuar dhe i parevokueshëm.

Neni 11

Raste të pezullimit të punës

11.1 Mediocredito Centrale, gjatë periudhës së vënies në punë të Kredisë Financiare, rezervohet të pezullojë furnizimin duke mos i dhënë rrugë të lirë kërkesave të akreditimit në bazë të nenit 6, që rezultojnë shkelje në lidhje me Mediocredito Centrale në bazë të kësaj Konvente Financiare ose të kredive të tjera financiare të dhëna nga vetë Mediocredito Centrale Qeverisë ose Bankës Qendrore ose e Enteve të Shtetit të Republikës së Shqipërisë, në bazë të Nenit 6 të ligjit italian nr.38 të 9 shkurtit 1979 dhe të Nenit 6 të ligjit italian nr.49 të 26 shkurtit 1987 dhe modifikime pasuese. Mediocredito Centrale do të japë komunikim të menjëhershëm për pezullimin ndaj Huamarrësit.

11.2 Në rastin kur Banka Agjente ballafaqohet me pengesë që, për motive të pavarura nga vullneti i saj, nuk e lejojnë t'i japë rrugë instruksioneve të akreditimit nga ana e Mediocredito Centrale në Llogarinë me Jashtë (shih Neni 7.6), e njëjta Bankë Agjente do t'i japë komunikim të menjëhershëm me shkrim Huamarrësit dhe vetë Mediocredito Centrale. Në momentin e eliminimit të këtyre pengesave, Banka Agjente do t'i japë rrugë, duke u lidhur me Mediocredito Centrale, instruksioneve të akreditimit të marra fillimisht nga vetë Mediocredito Centrale.

11.3 Mediocredito Centrale nuk do t'i japë rrugë kërkesave të akreditimit Neni 6.4, në rast se nuk janë të disponueshme shumat nga ana e Autoriteteve Kompetente Italiane.

Neni 12

Kamatvonesat

12.1 Në rast se, për një arsye çfardo, për të cilën nuk është përgjegjës Huamarrësi shumat e kapitalit dhe interesave nuk kthehen brenda afatit në Bankën Agjente brenda datës së skadimit, Huamarrësi është i detyruar të paguajë kamatvonesat e këtyre shumave për periudhën midis datës së mbarimit të afatit dhe datës së akreditimit efektiv, në favor të Mediocredito Centrale ose të ngarkuarve ligjorë pranë vetë Bankës Agjente.

12.2 Këto kamatvonesa do të llogariten në masën 0.25 (zero presje njëzet e pesë) për 35 (tridhjetë e pesë) ditët e mëpasshme nga data e mbarimit të afatit fillestar dhe, menjëherë më pas, në masën 5% (pesë për qind) deri në datën e pagesës efektive në Mediocredito Centrale.

12.3 Për 35 (tridhjetë e pesë) ditët menjëherë të mëpasshme nga data e mbarimit të afatit fillestar, këto kamatvonesa do të llogariten gjithnjë me regjimet e interesave të thjeshta; për periudhën e mëpasshme ato do të llogariten me regjimin e interesit të thjeshtë, kur kjo periudhë është më e vogël se një vit, dhe me regjimin e interesit të kombinuar, kjo periudhë është më e madhe se një vit.

Neni 13

Rimbursim i kuotave të financimit në rast mosrealizimi të Projekt/Programit:

13.1 Në rast mungese apo realizimi të pjesshëm të Projekt/Programit, Huamarrësi do të rimborsohet edhe për kuotat e lëvruara si parapagim, në bazë të kushteve të përcaktuara midis Mediocredito Centrale dhe Kompetentet e Autoriteteve italiane.

Neni 14

Detyrimet tatimore

14.1 Në bazë të Nenit 9.2 të mësipërm, çdo detyrim tatimor, aktual apo i ardhshëm për çfardo lloj detyrimi në Shqipëri, në varësi të Marrëveshjes Financiare në fuqi dhe të Deklaratës të Borxhit relativ me të, do të jetë ekskluzivisht në ngarkim të Huamarrësit.

14.2 Çdo detyrim tatimor në Itali, në varësi të Konventës Financiare nuk do të jetë në ngarkim të Huamarrësit.

14.3 Mediocredito Centrale deklaron se do të përdorë regjimin fiskal në nenin 19 të DPR nr.601 të 29 shtatorit 1973 dhe ndryshimet e mëvonshme.

Neni 15

Ligji i zbatueshëm

15.1 Kjo Konventë Financiare është hartuar në bazë të ligjit italian.

Neni 16

Mosmarrëveshje të mundshme

16.1 Palët do të përpiqen të zgjidhin miqësisht çdo lloj mosmarrëveshjeje që vjen nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj Konvente Financiare.

16.2 Në rast se përpjekje të tilla, brenda një kohe të arsyeshme, nuk do të çonin në zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve, këto do të zgjidhen në nivel qeveritar.

16.3 Në rast se një përpjekje e tillë nuk do të bëhej (ose do të bëhej) por nuk do të çonte në një zgjidhje të kënaqshme, të gjitha mosmarrëveshjet që vijnë nga kjo Konventë Financiare apo kanë lidhje me të do të zgjidhen përfundimisht sipas Rregullores së Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris, Francë, nga një Trup arbitror i përbërë nga tre anëtarë:

- një i caktuar huamarrësi;
- një i caktuar nga Mediocredito Centrale ;

- një i caktuar nga arbitrat e mësipërm ose, në rast mosmarrëveshjes, nga Presidenti i Dhomës së Tregtisë Ndërkombëtare të Parisit.

16.4 Në rast se Huamarrësi ose Mediokredito Centrale nuk kanë caktuar arbitrin e tyre brenda 30 ditëve duke filluar nga kërkesa e palës tjetër, arbitri do të caktohet nga Presidenti i Dhomës së Tregtisë Ndërkombëtare në Paris.

16.5 Vendimi i Trupit arbitror , i cili do gjykojë sipas ligjit italian, do të jetë përfundimtar dhe i parevokueshëm.

16.6 Pavarësisht nga çdo mosmarrëveshje që mund të lindë mes palëve Huamarrësi duhet të paguajë në afatet e caktuara, të gjitha shumat në varësi të kësaj Konvente Financiare dhe në veçanti të gjitha shumat që rrjedhin nga planet për shlyerje (Neni 8) dhe nga Deklarata e Borxhit në vijim.

Neni 17

Njoftime

17.1 Çdo njoftim që duhet zbatuar në lidhje me këtë Konventë Financiare duhet të drejtohet në adresat e mëposhtme:

- Huamarrësi: Ministria e Financave, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit - Tirana , Shqipëri.

- Banka Amerikane e Shqipërisë: Ismail Qemali 27 – PO. Box 8319 – Tiranë, Shqipëri.

-Mediokredito Centrale – Via Piemonte 51, 00187 Roma – Italia:

-Servizio Finanziamenti Strutturali: Ufficio Istruttoria Convenzioni Finanziarie: n.tel.0039 6 47912592/2749/2218, nr. telefax 0039 647912574/2970;

-Servizio Amministrazione – Ufficio Amministrazione Finanziamenti Strutturali: tel: 0039 64791 2380/2249/2516/2536/2206, telefax nr.0039 64791 2059/2758

-Banka Agjente: Banka Di Roma: Qendra operuese me jashtë 740/B, sekretar me jashtë - via dell’Unita, 79 00186 – Roma, Itali.

Neni 18

Origjinalet e Konventës Financiare

18.1 Kjo Konventë Financiare është hartuar dhe nënshkruar në katër origjinale në gjuhën italiane dhe në katër origjinale në gjuhën angleze prioritar, në raste mosmarrëveshjes, teksti i hartuar në gjuhën italiane.

Palët kanë nënshkruar Konventën Financiare në ditën dhe vendin e treguar.

Huamarrësi (Qeveria e Republikës së Shqipërisë)	Mediokredito Centrale
Ministria e Financave	Nga: Francesco Anania
	Kualifikimi: Drejtor
Nga: Anastas Angjeli	Firmosur në Tiranë, datë 20 Shkurt 2001
Kualifikimi : Ministër i Financave	
Firmosur në Tiranë, datë 20 Shkurt 2001	

(Faksimile e kërkesës për vënien në dispozicion të fondeve)

Aneksi B bashkëlidhur

Nga.....(Huamarrësi)

Për:.....Mediokredito Centre

Konventë financiare prej lireta.....(.....) nënshkruar nga ne.....

Me.....Dhe nga Mediokredito Centrale në..... me.....

Në bazë të nenit 6 të kësaj Konvente, ju kërkohet të vini në dispozicionin tonë për kreditim në "Llogarinë me jashtë", të hapur në emrin tonë pranë filialit të Romës....., ekuivalentin në lireta italiane të.....(.....) (shumë kontraktuale që mbulohet nga kjo kredi).

Saktësojmë që kjo shumë korrespondon me pagesat që duhet të bëjmë për..... në bazë të Kontratës furnizimit nr..... datë..... midis, në lidhje me(Projektin/Programin), për të cilin konfirmojmë rregullsinë. (Kopjen e së cilës do t'ua dërgojë ndërmarrja përfituese italiane).

Me qëllim lehtësimin e pagesave në favor të....., i kemi dhënë udhëzime Filialit të Romës..... t'ju kërkohet direkt, herë pas here, kreditimin në "Llogarinë me jashtë" të fondeve të nevojshme për kryerjen e pagesave të parashikuara në kontratën e furnizimit sa më sipër, sipas kushteve dhe mënyrave që përcaktohen në të.

Me anë të kësaj kërkesë, marrim përsipër detyrimin e pakushtëzuar dhe të parevokueshëm për të kthyer shumat që do të kreditohen nga Ju në "Llogarinë me jashtë", sipas mënyrave që përcaktohen në këtë Konventë Financiare.

Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga afati i fundit për përdorimin e kredisë së parashikuar në Nenin 4 të kësaj Konvente, marrim përsipër detyrimin t'ju lëshojmë një Njohje Borxhi për shumën kapital të barabartë me gjithë shumat e përdorura në bazë të kësaj Konvente Financiare.

Kjo Njohje Borxhi hartohet në përputhje me Aneksin E bashkëlidhur kësaj Konvente.

Përshëndetje të përzemërta.

(Faksimile e letrës Udhëzuese për Bankën Agjente)

Aneksi C – bashkëlidhur

Nga.....(Huamarrësi)

Për:.....(Bankën Agjente)

Për dijeni:.....(Mediocredito Centrale)

Konventë Financiare për Lit.....nënshkruar nga ne, në..... me..... dhe nga Mediocredito Centrale në.....me.....

Në bazë të Nenit 6 të kësaj Konvente Financiare dhe në vijim të letrës sonë, datë....., me anë të së cilës Ju kemi emëruar si Bankën Agjente, ju dërgojmë bashkëlidhur (Ndërmarrja përfituese italiane do ju dërgojë) një kopje të kontratës së furnizimit nr..... datë..... lidhur midis në lidhje me..... (projektin/Programin) për të cilën deklarojmë që kemi njohje të plotë.

Me anë të kësaj letrë ju autorizojmë, me cilësinë e Bankës sonë Agjente, të kryeni pagesat e parashikuara në kontratën e furnizimit sa më sipër sipas kushteve dhe mënyrave të përcaktuara në të, në favor të....., deri në një shumë maksimale të barabartë me Lit..... (.....) (shumë kontraktuale që mbulohet nga kjo kredi).

Pagesat që do të kryeni janë nën vartësinë e dorëzimit nga ana e ndërmarrjes përfituese italiane e dokumentacionit sipas kontratës (psh fatura, gjendja e avancimit të punimeve etj) dhe nga lëshimi i këtij të fundit të një kuitance në dy origjinale.

Për sa u tha më sipër, do i dorëzohet Mediocredito Centrale një kopje konform e dokumentacionit të sipërpërmendur dhe një origjinal i kuitancës dhe të na transmetohet një origjinal i dokumentacionit kontratual dhe kopia e dytë origjinale e kuitancës.

Gjithashtu, ju autorizojmë të kërkonti herë pas here direkt nga Mediocredito Centrale, kreditimin në "Llogarinë me jashtë" të fondeve të nevojshme për kryerjen e pagesave të parashikuara në kontratën sa më sipër, sipas kushteve dhe mënyrave të përcaktuara në të (çdo kërkesë duhet të na dërgohet me teleks, faks ose swift për dijeni).

Ju bëjmë të ditur, lidhur me këtë çështje se i kemi kërkuar Mediocredito Centrale të kreditojë herë pas here, në bazë të kërkesës suaj, në llogarinë e hapur në emrin tonë, fondet e nevojshme për kryerjen e pagesave në favor të për llogarinë tonë.

Kini mirësinë të na konfirmoni , me anë të një letre ose telex-i që duhet konfirmuar më pas me një letër, ne dhe Mediocredito Centrale, pranimin e këtyre udhëzimeve nga ana juaj.
Përshëndetje të përzemërta.

(Faksimile e kërkesë së akredituar)
Aneksi D) bashkëlidhur

Nga:.....(Banka Agjente)
Për: Mediocredito Centrale
Për:.....Huamarrësi (për dijeni)

Konventë Financiare për.....nënshkruar nga ne.....datë
..... dhe Mediocredito Central në..... datë.....
.....
.....

Në bazë të kësaj Konvente , mandatit dhe udhëzimeve të (huamarrësi), ju kërkojmë të kreditoni brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së kësaj letre, Lit.... (.....) në “Llogarinë me Jashtë” të hapur pranë nesh në emër të(huamarrësi)
Kjo shumë do të përdoret për kryerjen e pagesave në favor të....., pagesa që bëhen të detyrueshme nga dokumentat kontraktuale të mëposhtëm nr..... Datë..... lidhur midis..... dhe.....

.....
.....
.....

Lidhur me këtë çështje, vërtetojmë se Dokumentet e mëposhtëme Kontraktuale, një kopje e të cilave do ju dërgohet së bashku me origjinalin e deklaratës që çliron nga detyrimi, janë të rregullta dhe në përputhje me kontratën së cilës i referohen.

Vërtetojmë gjithashtu që pagesat sa më sipër përputhen me ligjet monetare në fuqi në Itali.
Përshëndetje të përzemërta.

(Faksimile e Njohjes së Borxhit)
Aneksi E) bashkëlidhur

.....(huamarrësi)

Nr.....
Vendi dhe data e lëshimit:

Në zbatim të Konventës Financiare midis(huamarrësi), si agjent dhe për llogari të Qeverisë së..... dhe Mediocredito Centrale, nënshkruar në..... me dhe në.....me.....,(huamarrësi) deklaron se ka marrë nga Mediocredito Centrale shumat e mëposhtëme:

.....me.....
.....me.....
.....me.....

Si rrjedhim,(huamarrësi) deklaron S.p.a. është debitor në mënyrë të pakushtëzuar dhe të parevokueshme ndaj Mediocredito Centrale S.p.a. – me seli në Romë (Itali), Via Piemonte 51, për shumën kapital Lit.....(.....) dhe merr përsipër detyrimin ta kthejë këtë shumë në (.....) këste simestrale, të barabarta dhe të

njëpasnjëshme, ku të parit këst i mbaron afati mëdhe të fundit....., sipas planit të shlyerjes.

Mbi shumën kapital të deklaruar në këtë Njohje Borxhi,(Huamarrësi) merr përsipër detyrimin të paguajë interesat sipas planit të shlyerjes bashkëngjitur, të llogaritur në zbatim të kësaj Konvente Financiare.

..... (Huamarrësi) do të kthejë kuotat e kapitalit dhe do të paguajë interesat e parashikuara në këtë njohje borxhi, duke i kredituar këto shuma brenda afateve përkatëse, në lireta italiane, në favor të Mediocredito Centrale ose të ngarkuarve ligjorë, në filialin e Romës italiane..... (“Banka Agjente”), pa zbritur asnjë detyrim bankar dhe/ose valutor.

Në rast se, për një arsye çfardo, për të cilën nuk është përgjegjëse Mediocredito Centrale, shumat e kapitalit dhe të interesit, të përcaktuara në këtë Njohje Borxhi, nuk derdhen brenda afatit për të cilin është rënë dakort, në filialin e Romës,.....(Huamarrësi) është i detyruar të paguajë, mbi këto shuma, kamatvonesat për periudhën nga data e mbarimit të afatit dhe datës së kreditimit efektiv në filialin e Romës..... në favor të Mediocredito Centrale ose të ngarkuarve ligjore të caktuar nga vetë Banka.

Këto kamatvonesa do të llogariten në masën% (.....për qind) për 35 (tridhjetë e pesë) dhe pas mbarimit të afatit fillestar dhe më pas, në masën 5% (pesë për qind) deri në pagesë efektive në Mediocredito Centrale.

Për 35 (tridhjetë e pesë) ditë pas datës së mbarimit të afatit fillestar, këto kamatvonesa do të llogariten gjithnjë me regjimin e interesave të thjeshta; për periudhën e mëpasme do të llogariten me regjimin e interesave të thjeshta, kur kjo periudhë është më e vogël se një vit, dhe me regjimin e interesave të kombinuara, kur kjo periudhë është më e gjatë se një vit.

Filiali i Romës.....Do të regjistrojë herë pas here në këtë Njohje Borxhi, pagesat e bëra sipas kuotave të kapitalit dhe interesave.

Me kryerjen e gjithë pagesave të parashikuara në planin e shlyerjes si më poshtë, kjo Njohje Borxhi i kthehet.....(Huamarrësit).

Kjo Njohje Borxhi lëshohet për Kredinë Financiare prej..... (.....) dhënë në bazë të Nenit 6 të ligjit italian Nr.49, datë 26 shkurt 1987.

Plani i shlyerjes

Mbarimi i afatit	Kuotat kapital	Kuotat e interesit	Totale
a).....
b).....
c).....
d).....
1).....
2).....
3).....
4).....
.....			
(Sigla e huamarrësit)			
5).....
6).....
7).....
8).....
9).....
10).....
11).....
12).....
13).....

.....
(Firma e huamarrësit)

(Faksimile e deklaratës së pagimit të borxhit)
Aneksi F) bashkëlidhur

Nga:.....Eksportuesi Italian
Për:(Huamarrësin)
Për:.....Mediocredito Centrale

Kuitancë e pagimit të borxhit

Në bazë të Kontratës Tregtare nr.....të nënshkruar në datë..... midis kësaj Shoqërie dhe..... për furnizimin e....., kjo Shoqëri deklaron se ka marrë në dorëzim shumën në lireta italiane prej.....me rregullim të pjesëshme/totale të kësaj kontrate.

Kjo shumë vjen nga kredito në lireta.....(.....), të vëna në dispozicion nga Mediocredito Centrale, Qeverisë sënë bazë të Nenit 6 të ligjit italian nr. 49 datë 26.2.1987 dhe modifikimet pasuese, me anë të kësaj Konventës Financiare të nënshkruar në..... datë..... dhe në Romë datë.....

Kështu, kjo Shoqëri deklaron se është plotësisht e kënaqur nga Krediti Financiar i mësipërm me shumën prej lit..... (.....), duke shkaktuar nga çdo detyrim dhe përgjegjësi në lidhje me shumën e marrë si..... (Huamarrësi), ashtu edhe Mediocredito Centrale.

L I G J
Nr.8770, datë 19.4.2001

PËR SHËRBIMIN E RUAJTJES DHE TË SIGURISË FIZIKE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Shoqëria e ruajtjes dhe e sigurisë fizike ka për mision:

- a) sigurimin e objekteve publike e private në pronësi ose në përdorim të personave fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë;
- b) sigurimin dhe mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të personave fizikë, shtetas shqiptarë ose të huaj;
- c) shoqërimin e vlerave monetare e materiale ose të sendeve të çmuara gjatë transportimit të tyre.

Neni 2

1. Shërbimi i ruajtjes dhe i sigurisë fizike kryhet nga subjekte private të organizuara në shoqëri tregtare nga shtetas shqiptarë ose në bashkëpunim me shtetas të huaj, të licencuar për këtë

qëllim, të cilat plotësojnë kushtet e përcaktuara në legjislacionin për shoqëritë tregtare dhe në këtë ligj.

2. Shërbimi i ruajtjes dhe i sigurisë fizike kryhet nëpërmjet marrjes së masave tekniko-administrative për mbrojtjen e jetës së personave, të objekteve publike ose private, në pronësi ose përdorim të personave juridikë ose fizikë, shqiptarë ose të huaj, si dhe për ruajtjen e sigurimin e vlerave monetare e materiale ose të sendeve të çmuara gjatë lëvizjeve.

3. Me punonjës shërbimi të shoqërisë së ruajtjes dhe sigurisë fizike kuptohet çdo shtetas shqiptar i pajisur me leje dhe armatim nga organet e Policisë së Shtetit, për të kryer shërbim në ruajtjen dhe sigurimin e objekteve publike dhe private.

4. Ruajtja dhe sigurimi i objekteve publike dhe private bëhet vetëm nga shoqëritë e krijuara dhe të licencuara për këtë qëllim.

Neni 3

1. Për ushtrimin e veprimtarisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike, shoqëria pajiset me licencë të lëshuar nga organi kompetent i përcaktuar në këtë ligj.

2. Licenca jepet pasi shoqëria të jetë regjistruar në regjistrin tregtar dhe të ketë përcaktuar në aktin e themelimit drejtuesin teknik. Ajo jepet me afat njëvjeçar, me të drejtë përtëritjeje, kur nuk kanë ndryshuar kushtet e dhënies së saj.

Neni 4

1. Licencat, në varësi të llojit të shërbimit, klasifikohen:

a) të kategorisë “a” që është e vlefshme për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve publike dhe private;

b) të kategorisë “b” që është e vlefshme për sigurimin fizik, mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të shtetasve, vendas dhe të huaj;

c) të kategorisë “c” që është e vlefshme për shoqërimin e vlerave monetare e të sendeve të çmuara.

2. Shoqëritë, me kërkesë të tyre, mund të pajisen njëkohësisht me licencë të kategorisë “a” dhe “b” (“a+b”).

3. Për nxjerrjen e licencës së kategorisë “a”, shoqëria duhet të ketë një kapital fillestar jo më të vogël se 2 000 000 lekë dhe drejtuesi teknik i zgjedhur duhet të ketë një përvojë pune, jo më pak se 5 vjet në shërbimet e Policisë së Shtetit ose në shërbimet e ruajtjes dhe të sigurisë fizike të këtyre lloj shoqërive.

4. Për nxjerrjen e licencës së kategorisë “b”, shoqëria duhet të ketë një kapital fillestar jo më të vogël se 3 000 000 lekë dhe drejtuesi teknik i zgjedhur duhet të ketë një përvojë pune, jo më pak se 5 vjet në shërbimet e Policisë së Shtetit ose në shërbimet e ruajtjes dhe të sigurisë fizike të këtyre lloj shoqërive.

5. Për nxjerrjen e licencës së kategorisë “a+b” shoqëria duhet të ketë një kapital fillestar jo më të vogël se 4 000 000 lekë dhe drejtuesi teknik i zgjedhur duhet të ketë një përvojë pune, jo më pak se 7 vjet në shërbimet e Policisë së Shtetit ose në shërbimet e ruajtjes dhe të sigurisë fizike të këtyre lloj shoqërive.

6. Për nxjerrjen e licencës së kategorisë “c”, shoqëria duhet të ketë një kapital fillestar jo më të vogël se 5 000 000 lekë dhe drejtuesi teknik i zgjedhur duhet të ketë një përvojë pune, jo më pak se 10 vjet në shërbimet e Policisë së Shtetit ose në shërbimet e ruajtjes dhe të sigurisë fizike të këtyre lloj shoqërive.

7. Ministri i Rendit Publik dhe Ministri i Financave të përcaktojnë me urdhër të përbashkët ndryshimin e vlerave të kapitalit fillestar, në përputhje me nivelin e inflacionit.

Neni 5

1. Shoqëritë e pajisura me licencë të kategorisë “a” ushtrojnë veprimtari brenda juridiksionit territorial të qarkut të përcaktuar në licencë.

2. Shoqëritë e pajisura me licencë të kategorisë “b”, “c” dhe “a+b” ushtrojnë veprimtari në të gjithë territorin e vendit.

Neni 6

1. Marrëdhëniet ndërmjet shoqërive të ruajtjes dhe të sigurisë fizike dhe të personit fizik a juridik që merret në ruajtje, rregullohen me marrëveshje të përbashkët, ku pjesë e saj duhet të jetë rregullorja e shërbimit dhe sipas rastit rregullorja e brendshme e objektit.

2. Marrëveshja nënshkruhet ndërmjet drejtuesit teknik të shoqërisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike dhe personit të autorizuar nga personi fizik a juridik që merret në ruajtje.

3. Rregullorja e shërbimit, që është pjesë e marrëveshjes së nënshkruar nga palët, hartohet sipas rregullores tip, të miratuar me urdhër të Ministrit të Rendit Publik.

Neni 7

1. Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit krijohet Komisioni i Shqyrtimit të Licencave.

2. Kërkesat për marrjen e licencës sipas kategorive paraqiten pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, së bashku me dokumentacionin përkatës, të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Rendit Publik.

3. Komisioni i Shqyrtimit të Licencave e shqyrton kërkesën brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës dhe në përfundim i paraqet autoritetit lëshues vlerësimin përkatës.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit është autoriteti i ngarkuar për lëshimin e të gjitha kategorive të licencave.

Neni 8

1. Uniforma e punonjësit të shërbimit të shoqërive të ruajtjes dhe të sigurisë fizike është e njëjtë për të gjitha shoqëritë, por e ndryshme nga ajo e Policisë së Shtetit. Ajo përcaktohet me urdhër të Ministrit të Rendit Publik.

2. Në uniformë vendoset dukshëm stema, e cila është e veçantë për çdo shoqëri. Stema miratohet nga organi licencues në çastin kur jepet licenca.

3. Ndalohet mbajtja e uniformës jashtë kohës së shërbimit.

Neni 9

1. Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe punonjësi i shërbimit pajisen me armatim, municion dhe mjete speciale, të përshtatshme për kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe të sigurisë fizike.

2. Lloji e sasia e armatimit, e municionit dhe e mjeteve speciale, përcaktohen me urdhër të Ministrit të Rendit Publik.

Neni 10

1. Shoqëria, për përmbushjen e misionit të vet, ka të drejtë të vendosë mjete ose sisteme vrojtuese, sinjalizuese, audiovizive, pajisje ndërlidhjeje, si dhe të përdorë teknika të tjera, duke respektuar legjislacionin në fuqi.

2. Për ruajtjen e objekteve, shoqëria mund të përdorë edhe qen shërbimi, duke marrë masat përkatëse për parandalimin e pasojave që mund të sjellë ky lloj shërbimi.

Neni 11

1. Shoqëria ka në përbërje të personelit të ruajtjes dhe të sigurisë fizike drejtues teknikë dhe punonjës shërbimi, të cilët pajisen me lejen përkatëse për ushtrimin e profesionit.

2. Numri i personelit të shërbimit të shoqërisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike është deri në 5 për qind e efektivit të drejtorisë së policisë së qarkut, ku kjo shoqëri ushtron veprimtarinë, ndërsa numri i armatimit të saj është deri në 2 për qind të numrit të armatimit të efektivit të drejtorisë së policisë të qarkut.

Neni 12

1. Drejtuesi teknik është drejtuesi më i lartë teknik i shoqërisë dhe përgjegjësi ligjor për drejtimin, bashkërendimin dhe kontrollin e shërbimit të ruajtjes dhe të sigurisë fizike.

2. Kur, për shkaqe të arsyeshme drejtuesi teknik largohet nga shoqëria, kjo është e detyruar të njoftojë menjëherë drejtorin e policisë së qarkut, ku ushtron veprimtarinë, ndërsa për shoqëritë e kategorisë “c” njoftohet Drejtori i Përgjithshëm i Policisë. Në këto raste, shoqëria, brenda 45 ditëve, i paraqet autoritetit licencues kërkesën për zëvendësimin e drejtuesit teknik, si dhe për pajisjen e tij me lejen përkatëse, nëse ai nuk ka një të tillë.

Neni 13

Punonjësi i shërbimit vepron me cilësinë e rojes, të truprojes, të operatorit dhe kryen detyra të tjera të ngjashme me to, si dhe përmbush detyrat e ruajtjes dhe të sigurisë fizike, të përcaktuara në këtë ligj. Ai ka përgjegjësi ligjore për ruajtjen dhe sigurimin e objektit.

Neni 14

1. Pajiset me leje, për ushtrimin e profesionit të drejtuesit teknik, personi që plotëson këto kushte:

- a) Ka zotësi të plotë për të vepruar.
- b) Është shtetas shqiptar me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.
- c) Ka kryer arsimin e lartë policor.
- ç) Nuk ka qenë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.
- d) Është me moshë nën 60 vjeç.

2. Autoriteti për dhënien e lejes për ushtrimin e veprimtarisë së drejtuesit teknik të shoqërisë është Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

3. Procedurat për dhënien e lejes bëhen sipas nenit 7 të këtij ligji.

Neni 15

1. Pajiset me leje, për ushtrimin e profesionit të punonjësit të shërbimit, personi që plotëson këto kritere:

- a) Ka zotësi të plotë për të vepruar.
- b) Është shtetas shqiptar me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.
- c) Nuk ka qenë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.
- ç) Ka kryer arsimin e detyrueshëm.
- d) Ka kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak.
- dh) Plotëson kushtet ligjore për mbajtjen dhe përdorimin e armëve.
- e) Është i aftë nga ana shëndetësore dhe ka gjatësi trupore mbi 160 cm.
- ë) Plotëson kërkesat e nenit 16 të këtij ligji.

2. Autoriteti për dhënien e lejes për ushtrimin e profesionit të punonjësit të shërbimit është drejtori i policisë së qarkut, ku ushtron veprimtarinë shoqëria. Kërkesa për dhënien e lejes paraqitet nga shoqëria pranë drejtorisë së policisë së qarkut së bashku me dokumentacionin përkatës, të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Rendit Publik.

3. Kjo kërkesë shqyrtohet brenda 30 ditëve nga komisioni i shqyrtimit të lejeve pranë drejtorisë së policisë së qarkut, i cili, në përfundim, i paraqet autoritetit lëshues vlerësimin përkatës.

Neni 16

1. Punonjësi i shërbimit, para dhënies së lejes së ushtrimit të profesionit, i nënshtrohet një kursi kualifikimi për një periudhë kohe jo më pak se 15 ditë, nën drejtimin e drejtuesit teknik të shoqërisë dhe në përfundim të këtij kursi testohet nga një komision i posaçëm, i krijuar nga organi lëshues i lejes.

2. Punonjësi i shërbimit i nënshtrohet kurseve të kualifikimit të organizuara nga shoqëria, të cilat zgjasin jo më pak se 5 ditë në çdo vit kalendarik.

3. Programet e kualifikimit dhe të testimi hartohen dhe miratohen nga organet e Policisë së Shtetit, të specializuara për këtë shërbim.

4. Organet e Policisë së Shtetit në qark herë pas here mbikëqyrin kurset e kualifikimit të punonjësve të shërbimit të organizuara nga shoqëria.

Neni 17

Drejtuasi teknik i shoqërisë është i detyruar të njoftojë menjëherë organin e Policisë së Shtetit për çdo ngjarje që ndodh në objektet që ka në ruajtje shoqëria dhe çdo tre muaj njofton me shkrim për kryerjen e detyrave të ruajtjes dhe të sigurisë fizike, si dhe për problemet që kanë lindur.

Neni 18

1. Punonjësit e shërbimit kanë të drejtë të kërkojnë nga shtetasit zbatimin e rregullave të vendosura për hyrjen dhe daljen në objektin dhe/ose në territorin që ruajnë e të rregullave të tjera të përcaktuara në rregulloren e brendshme të objektit.

2. Kur vërejnë se në objektin që kanë në ruajtje ka ndodhur një veprë penale, menjëherë, në varësi të organizimit të shërbimit, njoftojnë organet e Policisë së Shtetit dhe marrin masa për ruajtjen dhe sigurimin e vendit të ngjarjes, deri në ardhjen e punonjësve të Policisë së Shtetit.

3. Punonjësit e shërbimit përdorin armët që kanë, në rastet dhe kushtet e përcaktuara në ligjin nr.8290, datë 24.2.1998 “Për përdorimin e armëve të zjarrit”.

4. Punonjësit e shërbimit kanë të drejtë dhe detyrë të ndalojnë personat që përgatiten të kryejnë, kanë kryer ose dyshohet se kanë kryer një veprë penale në objektin që ruajnë ose që ka lidhje me këtë objekt.

5. Punonjësit e shërbimit e kanë për detyrë t’u japin të dhëna punonjësve të Policisë së Shtetit sa herë që iu kërkohet, për problemet e ruajtjes dhe të sigurisë së objektit.

6. Të drejtat dhe detyrat e përcaktuara për punonjësit e shërbimit në pikat 2 e 4 të këtij neni, zbatohen edhe në rastet e ruajtjes e të sigurimit të personave fizikë, si dhe të vlerave monetare e materiale dhe sendeve të çmuara në shoqërim gjatë lëvizjes.

Neni 19

Organet e Policisë së Shtetit e kanë për detyrë dhe të drejtë të kontrollojnë në çdo kohë kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe të sigurisë fizike, sipas rregullave të përcaktuara me udhëzim të Ministrisë të Rendit Publik.

Neni 20

1. Shkelja e rregullave të parashikuara në nenet 5, 6, 11, 12, 14 e 17 të këtij ligji përbëjnë kundërvajtje administrative dhe shoqëria e ruajtjes dhe e sigurisë fizike dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 200 000 lekë, ndërsa drejtuesi teknik i shoqërisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike dënohet me gjobë nga 20 000 deri 50 000 lekë. Të drejtën e gjobës e ka drejtori i policisë së qarkut.

2. Shkelja e rregullave të parashikuara në nenet 8 dhe 18 të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe punonjësi i shërbimit të shoqërisë dënohet me gjobë nga 5 000 deri 10 000 lekë. Të drejtën e gjobës e ka drejtori i policisë së qarkut.

Neni 21

1. Shoqërisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike i hiqet licenca nga autoriteti që e ka lëshuar atë, në rastet kur:

a) vërtetohet se licenca është marrë në bazë të dokumenteve dhe të të dhënave të falsifikuara;

b) është dënuar administrativisht me gjobë për të njëjtën shkelje në mënyrë të përsëritur;

c) nuk fillon ushtrimin e veprimtarisë për një periudhë 3-mujore nga data e marrjes së licencës;

ç) nuk shlyen detyrimet financiare, të parashikuara në ligj.

2. Drejtuesit teknik i hiqet leja nga autoriteti lëshues kur:

a) vërtetohet se leja është marrë në bazë të dokumenteve dhe të të dhënave të falsifikuara;

b) është dënuar administrativisht me gjobë për të njëjtën shkelje në mënyrë të përsëritur;

c) kanë ndryshuar kushtet e kërkuara në nenin 14 të këtij ligji;

ç) nuk fillon ushtrimin e veprimtarisë për një periudhë 3-mujore nga data e marrjes së licencës.

3. Punonjësit të shërbimit i hiqet leja e ushtrimit të profesionit kur:

a) vërtetohet se leja është marrë në bazë të dokumenteve dhe të të dhënave të falsifikuara;

b) është dënuar administrativisht me gjobë për të njëjtën shkelje në mënyrë të përsëritur.

c) kanë ndryshuar kushtet e kërkuara në nenin 15 të këtij ligji.

Neni 22

1. Objektet më të rëndësishme shtetërore, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, ruhen dhe sigurohen me punonjës të Policisë së Shtetit.

2. Rregullat për ruajtjen dhe sigurimin e këtyre objekteve nuk i nënshtrohen këtij ligji.

Neni 23

Ligji nr.7550, datë 20.1.1992 “Për policinë e objekteve”, ligji nr.7696, datë 7.4.1993 “Për shërbimin e rojeve civile” dhe ligji nr.7985, datë 13.9.1995 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7696, datë 7.4.1993 “Për shërbimin e rojeve civile”” shfuqizohen.

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2993, datë 4.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Rexhep Meidani.**

L I G J
Nr. 8771, datë 19.4.2001

PËR KUFIRIN SHTETËROR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Përcaktimi i kufirit shtetëror dhe paprekshmëria e tij

1. Kufiri shtetëror i Republikës së Shqipërisë përcaktohet në aktet ndërkombëtare dhe në aktet e tjera ndërkombëtare dypalëshe të përfunduara mes shtetit shqiptar dhe shteteve fqinjë. Ai nuk mund të ndryshojë përveçse në bazë të marrëveshjeve, akteve dhe normave të së drejtës ndërkombëtare të njohura dhe të nënshkruara nga Shteti Shqiptar.

2. Kufiri shtetëror i Republikës së Shqipërisë është i paprekshëm.

Neni 2

Tregimi i kufirit shtetëror

Kufiri shtetëror i Republikës së Shqipërisë tregohet me anë të shenjave të veçanta artificiale ose natyrore të vendosura mbi sipërfaqen tokësore dhe ujore. Vijat e hequra perpendikularisht (lart e poshtë) mbi vijën e kufirit në sipërfaqen tokësore dhe ujore përbëjnë përkatësisht, kufijtë e hapësirës ajrore, të nëntokës dhe të shtratit e të nëntokës së ujërave të brendshme dhe ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Ujërat territoriale dhe ujërat e brendshme

1. Ujërat territoriale të Republikës së Shqipërisë shtrihen gjatë gjithë bregut të saj, në një gjerësi prej 12 miljesh detare, duke filluar nga vija e drejtë bazë që shkon nga Kepi i Rodonit (Muzhit), Kepi i Pallës, i Lagjit (Kalasë së Turrës), derdhja e Semanit, derdhja e Vjosës, bregu perëndimor i Ishullit të Sazanit, Kepi i Gjuhëzës dhe i Gjiut të Gramës, dhe mandej midis bregdetit shqiptar dhe ishujve të Republikës Greke deri përmes Kanalit të Korfuzit. Gjerësia e ujërave territoriale nga derdhja e Bunës në det deri te Kepi i Rodonit shtrihet deri në vijën e kufirit shqiptaro-jugosllav (Mali i Zi).

2. Janë ujëra të brendshme të Republikës së Shqipërisë ujërat e Detit Adriatik dhe të Detit Jon që shtrihen brenda vijës së drejtë bazë që përshkon derdhjen e Lumit të Bunës, kepat e përmendur në pikën 1 të këtij neni dhe vijës së drejtë bazë që përshkon Kepin e Gjiut të Gramës, Kepin e Gjiut të Palermos, Kepin e Qefalit, Kepin e Sarandës, si dhe ujërat këtej vijës kufitare të liqeneve dhe lumenjve kufitarë.

Neni 4

Ushtrimi i sovranitetit

1. Republika e Shqipërisë ushtron sovranitetin e saj mbi ujërat territoriale dhe ujërat e brendshme në bazë të ligjeve, të marrëveshjeve ndërkombëtare në të cilat ajo është palë dhe të normave të së drejtës ndërkombëtare të njohura nga Shteti Shqiptar.

2. Sovraniteti i Republikës së Shqipërisë shtrihet edhe në hapësirën ajrore mbi ujërat territoriale dhe në shtratin dhe nëntokën e këtyre ujërave.

3. Republika e Shqipërisë ushtron sovranitetin e saj mbi rafshnaltën (shelfin) kontinental për qëllime kërkimi dhe shfrytëzimi të burimeve të saj natyrore.

Neni 5

Regjimi i lundrimit dhe ai i fluturimit

Regjimi i lundrimit në ujërat territoriale dhe në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë, regjimi i fluturimit në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë dhe regjimi i ruajtjes dhe kontrollit të kufirit shtetëror përcaktohen në ligje të veçanta.

Neni 6

Shfuqizime

Dekreti nr. 4650, datë 9.3.1970 “Për kufirin shtetëror të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ndryshuar me dekretet nr.5384, datë 23.2.1976 dhe nr.6181, datë 26.4.1980, shfuqizohet.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2994, datë 4.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Rexhep Meidani**

L I G J

Nr. 8772, datë 19.4. 2001

PËR RUAJTJEN DHE KONTROLLIN E KUFIRIT SHTETËROR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Objekti i këtij ligji

Ky ligj përcakton:

- a) rregullat e ruajtjes dhe të kontrollit të kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë;
- b) rregullat për kalimin e shtetasve shqiptarë ose të huaj dhe të mjeteve nga dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) strukturën shtetërore dhe statusin e saj, me qëllim garantimin e zbatimit të këtyre rregullave.

Neni 2 Përkufizime

Në zbatim të këtij ligji termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Kalim i kufirit” kuptohet veprimi që kryhet për kalimin nga territori i një shteti në territorin e një shteti tjetër.
2. “Kontroll i kalimit të kufirit shtetëror” kuptohet kontrolli i personave dhe i mjeteve që hyjnë ose dalin në vendkalimet kufitare dhe të vlefshmërisë së dokumentacionit të tyre në çastin e kalimit të kufirit shtetëror.
3. “Ruajtja dhe kontrolli i kufirit shtetëror” kuptohet vëzhgimi dhe kontrolli i lëvizjeve në të dyja anët e kufirit shtetëror për parandalimin e veprimtarisë së paligjshme dhe të incidenteve kufitare.
4. “Vendkalim kufitar” kuptohet ajo pjesë e kufirit tokësor, ujor dhe ajror ku lejohet kalimi i ligjshëm i kufirit shtetëror.
5. “Vijë kufiri” kuptohet vija ndarëse, imagjinare ose e vërtetë, që ndan territorin e Republikës së Shqipërisë nga territori i shteteve fqinjë në tokë, në nëntokë, në lumenj, në liqene, në det dhe në hapësirën ajrore. Me të barazohet edhe vija ndarëse e territorit të përfaqësive diplomatike, të mjeteve lundruese dhe atyre fluturuese që mbajnë ligjërisht flamurin e një shteti tjetër.
6. “Zona e kontrollit të kalimit të kufirit shtetëror” kuptohet pjesa e territorit në vendkalimin kufitar, ku kryhet kontrolli i kalimit të kufirit.

KREU II POLICIA KUFITARE

Neni 3 Struktura dhe veprimtaria

1. Policia Kufitare përgjigjet për kontrollin e kalimit të ligjshëm të kufirit, si dhe për ruajtjen dhe kontrollin e tij. Ajo është pjesë përbërëse e Policisë së Shtetit.
2. Veprimtaria e Policisë Kufitare bazohet në Kushtetutë, në ligjin për Policinë e Shtetit, në aktet dhe marrëveshjet ndërkombëtare, që rregullojnë problemet kufitare dhe emigracionin në të cilat shteti ynë është palë, në këtë ligj dhe në dispozitat e tjera ligjore.
3. Policia Kufitare ka strukturën dhe organikën e saj të cilat miratohen nga Ministri i Rendit Publik.

Neni 4 Detyrat e Policisë Kufitare

Policia Kufitare ka këto detyra:

1. Mban nën vëzhgim gjendjen në kufirin shtetëror.
2. Kontrollon në mënyrë periodike shenjat kufitare dhe zbaton detyrimet e ndërsjella të marrëveshjeve të pranuar për vijën e kufirit me shtetet fqinjë.
3. Zbaton dhe merr masa për parandalimin e kalimit të paligjshëm të kufirit.
4. Kryen procedurat ligjore për verifikimin, zbulimin, dokumentimin, kapjen, arrestimin në flagrancë të personave që kryejnë veprimtari të paligjshme dhe bllokon mjetet e transportit që hyjnë ose dalin nëpërmjet kufirit me dokumente të parregullta.
5. Verifikon të dhënat e nevojshme, kontrollon dhe refuzon në vendkalimet kufitare dhe në vijën e kufirit shtetasit e huaj dhe mjetet që kalojnë ose përpiqen të kalojnë kufirin në mënyrë të paligjshme. Në këto raste, kur shtetasit e huaj nuk pranojnë të kthehen mbrapsht ose kapen në thellësi të territorit shqiptar dhe arrihet në përfundimin se kanë hyrë në mënyrë të paligjshme, ata

dërgohen në qendrat e grumbullimit dhe të trajtimit të përkohshëm të të huajve.

6. Merr masa për ndalimin e personave që kryejnë veprimtari të kundërligjshme nëpërmjet kufirit dhe të personave të kërkuar; bën bllokimin e mjeteve dhe të mallrave që hyjnë në mënyrë të kundërligjshme dhe, kur krijon dyshime ose vihet në dijeni për shkeljet të dispozitave të Kodit Doganor, njofton zyrën doganore përgjegjëse.

7. Merr masa për garantimin e zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet kufitare me shtetet fqinjë për parandalimin dhe zgjidhjen e incidenteve kufitare.

8. Kontrollon zbatimin e rregullave të qarkullimit në vijën e kufirit, ndihmon në sigurimin e jetës dhe të pronës të banorëve në zonat kufitare, si dhe zbaton masa parandaluese ndaj shkeljeve të territorit të Republikës së Shqipërisë nga shtetas dhe mjete të huaja.

9. Grumbullon të dhëna në interes të shërbimit për ruajtjen dhe kontrollin e kufirit, si dhe të kalimit të tij.

10. Merr masa për parandalimin e incidenteve kufitare dhe në situata të veçanta për përballimin e provokimeve dhe provokacioneve në kufirin shtetëror.

11. Kontrollon zbatimin e regjimit të lundrimit të mjeteve lundruese në ujërat e brendshme dhe territoriale të Republikës së Shqipërisë.

12. Kontrollon dokumentacionin identifikues të personave dhe të automjeteve gjatë kalimit në vendkalimet kufitare dhe në sektorët e tjerë të shërbimit.

13. Zbaton detyrimet që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare, marrëveshjet dy a shumëpalëshe për lëvizjen e mjeteve dhe të njerëzve.

14. Në vendvendosjet e veta kryen edhe detyrat e ruajtjes së rendit dhe të qetësisë publike, ndërsa në vendkalimet kufitare edhe detyrat e Policisë Rrugore.

15. Kontrollon vlefshmërinë e dokumenteve për kalimin e kufirit të Republikës së Shqipërisë nga shtetasit dhe mjetet e transportit.

16. Jep viza dhe konfirmim për viza në kufi brenda përgjegjësive të njohura me akte ligjore dhe nënligjore.

17. Evidenton të dhënat e nevojshme të dokumentacionit përkatës të shtetasve ose mjeteve, rrethana të rëndësishme ose të dhëna të tjera për kalimin ose moslejimin e kalimit të kufirit.

18. Kur është e nevojshme kryen kontroll vetjak fizik dhe të imët të personave, të bagazheve dhe të mjeteve.

19. Jep udhëzimet e nevojshme për zbatimin e procedurave të kontrollit dhe të kalimit të kufirit.

20. Kërkon në vendkalimin kufitar nga shtetasit shqiptar dhe të huaj zbatimin e rregullave të kontrollit dhe sqarimin e të gjitha rrethanave që kanë të bëjnë me kalimin e kufirit, të përcaktuar nga ky ligj dhe nga akte nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

21. Refuzon hyrjen ose daljen e shtetasve të huaj ose të mjeteve të shtetasve shqiptarë ose të huaj, nga dhe në Republikën e Shqipërisë, kur nuk përmbushen kërkesat e përcaktuara me ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare.

22. Realizon takime me organet simotra të shteteve fqinjë dhe të vendeve të tjera për zbatimin e marrëveshjeve të përbashkëta dhe për shkëmbimin e të dhënave në interes të zbatimit të tyre.

23. Të sigurojë që azilkërkuesit ose personat të cilëve u është dhënë azil të mos kthehen ose dërgohen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

24. Të marrë kërkesat për azil nga të huajt në vendkalimet e kufitare. Kërkesa për azil është çdo deklaratë (me gojë, me shkrim ose me gje) e një të huaji përmes së cilës ai kërkon mbrojtje në Republikën e Shqipërisë. Në këtë rast Policia Kufitare njofton Zyrën për Refugjatët dhe UNHCR-në për faktin e marrjes së një kërkesë të tillë të cilët nga ana e tyre sigurojnë transportin e azilkërkuesit për në qendrën përkatëse të pritjes. Derisa ky transferim të kryehet, Policia Kufitare siguron që azilkërkuesi të mos kthehet në vendin prej të cilit ai ka ardhur.

Neni 5

Trajtimi i të huajve që hyjnë në mënyrë të paligjshme

1. Të huajt, që hyjnë në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që kapen nga policia në afërsi të kufirit ose në thellësi të vendit, dërgohen në qendrat e grumbullimit dhe të trajtimit të përkohshëm të të huajve.

2. Vendi i ngritjes së këtyre qendrave dhe rregullat e funksionimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Bashkëpunimi

1. Për ruajtjen dhe kontrollin e kufirit shtetëror, si dhe kontrollin e kalimit të tij, Policia Kufitare bashkëpunon me institucionet e tjera shtetërore, organet e qeverisjes vendore në territorin ku ajo është vendosur, si dhe me subjekte të tjera private.

2. Për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj, Policia Kufitare bashkëpunon me policitë simotra të vendeve fqinjë dhe të shteteve të tjera.

Neni 7

Mjetet dhe teknika e veçantë

Për realizimin e detyrave të përcaktuara në këtë ligj, Policia Kufitare pajiset me mjete dhe teknika të veçantë, lloji dhe përdorimi i të cilave përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Rendit Publik.

KREU III

RUAJTJA DHE KONTROLLI I KUFIRIT SHTETËROR

Neni 8

Ruajtja dhe kontrolli i kufirit shtetëror

Ruajtja dhe kontrolli i kufirit shtetëror ka si qëllim të sigurojë paprekshmërinë e integritetit territorial të Republikës së Shqipërisë, mirëmbajtjen e shenjave kufitare, garantimin e jetës dhe të pronës së individëve që banojnë ose ushtrojnë veprimtari pranë vijës së kufirit, parandalimin e incidenteve dhe provokimeve kufitare, si dhe ndalimin e kalimit të paligjshëm të kufirit të personave, mjeteve ose mallrave.

Neni 9

Shenjat treguese

Vendosja e shenjave treguese në vijën së kufirit shtetëror, mirëmbajtja e tyre dhe pastrimi i vijës së kufirit kryhet nga Policia Kufitare në përputhje me marrëveshjet e nënshkruara me shtetet fqinjë.

Neni 10

Komisionet e përbashkëta

1. Për parandalimin dhe zgjidhjen e incidenteve kufitare krijohen komisionet e përbashkëta vendore ose qendrore me marrëveshje me shtetet fqinjë.

2. Veprimtaria e këtyre komisioneve rregullohet me marrëveshjet e përfunduara me vendet fqinjë dhe me udhëzimet e Ministrit të Rendit Publik.

Neni 11
Pastrimi i vijës së kufirit

1. Përgjatë kufirit shtetëror në tokë, sipas marrëveshjeve përkatëse, pastrohet vija e kufirit nga bimësia. Pranë kësaj vije, për sigurimin e dukshmërisë, ndalohet mbjellja e pemëve dhe e kulturave bujqësore.

2. Në largësinë 50 m nga vija e kufirit nuk lejohet ndërtimi i objekteve. Në raste të veçanta, për interesa të sigurimit kombëtar mund të bëhen ndërtime me leje të dhëna nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë.

3. Për ruajtjen dhe kontrollin e kufirit shtetëror, pronarët e tokës janë të detyruar të lejojnë kryerjen e shërbimeve nga Policia Kufitare dhe vendosjen e shenjave kufitare.

Neni 12
Lëvizja dhe veprimtaria pranë vijës së kufirit

1. Lëvizjet ose veprimtaritë e tjera në largësinë 300 m nga vija e kufirit shtetëror në të gjithë gjatësinë dhe thellësinë e territorit shqiptar, kryen pasi të jetë venë në dijeni Policia Kufitare. Nga ky rregull përjashtohen banorët e fshatrave të parë në afërsi të vijës së kufirit.

2. Përgjatë vijës së kufirit shtetëror caktohet zonë kufitare me thellësi 10 km në të cilën Policia Kufitare ka të drejtë të ushtrojë kontroll vetjak ndaj shtetasve, mjeteve dhe mallrave, kur ka të dhëna se ku kontrolli duhet të ushtrohet me qëllim mënjanimin e një rreziku që i kanoset sigurisë publike.

3. Në zonat malore ose në zona të veçanta kufitare larg qendrave të banuara, lëvizja, veprimtaritë ekonomike, kulturore ose fetare bëhen sipas rregullave të përcaktuara nga organet e pushtetit vendor në bashkëpunim me Policinë Kufitare.

Neni 13
Ndalimi i gjuetisë

Në afërsi të vijës së kufirit ndalohet gjuetia me armë zjarri dhe përdorimi i lëndëve plasëse. Në raste të veçanta përdorimi i tyre lejohet vetëm me miratim të Policisë Kufitare vendore.

Neni 14
Pandryshueshmëria e statusit

Statusi i Policisë Kufitare nuk ndryshon edhe në gjendjen e luftës, gjendjen e jashtëzakonshme ose gjendjen e fatkeqësisë natyrore. Në këto raste bashkëpunohet në mënyrë të ndërsjellë me strukturat përkatëse të Forcave të Armatosura.

KREU IV
KONTROLLI NË KUFİ

Neni 15
Kontrolli nga Policia Kufitare

Shtetasit shqiptarë ose të huaj dhe mjetet e transportit që hyjnë ose dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë i nënshtrohen kontrollit të Policisë Kufitare. Përjashtim nga ky kontroll bëhet në rastet e veçanta të përcaktuara në ligj ose në marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 16

Vendi i kontrollit të kalimit të kufirit

1. Policia Kufitare zbaton procedurat e kontrollit të kalimit të kufirit shtetëror brenda zonës së kontrollit të kalimit të kufirit.

2. Në rastet kur në zbatim të një marrëveshjeje ndërkombëtare, kontrolli kryhet në territorin e një shteti fqinj, organi kufitar detyrohet të respektojë kërkesat e kësaj marrëveshjeje.

Neni 17

Kontrolli në mjetet e transportit

Në marrëveshje me shtetet e tjera dhe sipas kontratave të lidhura me agjencitë e transportit, kontrolli i Policisë Kufitare në trena, aeroplanë, anije tragete dhe mjete të tjera transporti mund të kryhet edhe gjatë udhëtimit jashtë zonës së kontrollit.

Neni 18

Kontrolli në situata të veçanta

Në rastet e dendësimit të madh të trafikut të mjeteve, ngjarjeve të rënda ose për shkak të një force madhore, kur nuk cenohen interesat e rendit publik ose për përshpejtimin e kalimit të personave dhe të mjeteve me ndihma humanitare, me kërkesë të organizatave ndërkombëtare të interesuara lejohet kalimi i kufirit shtetëror me procedura të përshpejtuara kontrolli ose duke kryer kontroll me intervale. Në këto raste autorizimi jepet nga titullarët e institucioneve qendrore përkatëse.

Neni 19

Mjetet e veçanta

1. Punonjësit e Policisë Kufitare në vendkalime kufitare, në porte dhe në aeroporte pajisen me mjete të veçanta për parandalimin e veprimeve me rrezikshmëri për sigurinë e jetës së personave që udhëtojnë dhe për kontrollin e bagazheve të tyre.

2. Lloji i këtyre pajisjeve dhe mënyra e përdorimit të tyre përcaktohen me udhër të Ministrit të Rendit Publik.

Neni 20

Autoritet shtetërore

Autoritetet shtetërore, që ushtrojnë veprimtari në zonën e kontrollit të kalimit të kufirit shtetëror, pajisen me uniformë dhe me dokument identifikimi, të lëshuar nga drejtuesit e tyre.

Neni 21

Lejet për në vendkalimet kufitare

1. Lëvizja dhe qëndrimi i personave të tjerë në vendkalimet kufitare bëhet vetem me leje të policisë vendore kufitare. Leja jepet me afat ditor, sipas modelit të miratuar nga Ministri i Rendit Publik.

2. Drejtuesit e institucioneve dhe organizmave qendrorë pajisen me leje me afat 1-vjeçar. Për hyrje dhe qëndrim në zonën e kontrollit të kalimit të kufirit, leja lëshohet nga Drejtori i Policisë Kufitare.

Neni 22
Detyra të Policisë Kufitare

Policia Kufitare, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të pranuar, dorëzon ose merr në dorëzim nga shteti tjetër persona me shtetësi shqiptare, persona që ekstradohen ose të tjerë që kanë kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme ose kanë kryer shkelje të ligjshmërisë.

KREU V
KALIMI I KUFIRIT

Neni 23
Kalimi i kufirit

1. Kalimi i kufirit bëhet me dokumente të rregullta dhe vetëm në vendkalimet kufitare. Hyrja e dalja e të huajve nga dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë bëhet në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë ligj, duke u paraqitur përpara punonjësve të Policisë Kufitare.

2. Kalimi i kufirit jashtë vendkalimeve kufitare lejohet vetëm në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe në rastet e forcës madhore.

3. Një person, që hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë për të kërkuar azil ose e ka kërkuar atë tek autoritetet e Policisë Kufitare, lejohet të hyjë ose të qëndrojë në territorin shqiptar pa dokumentet e kërkuara për hyrjen dhe qëndrimin e të huajve të vendosura nga ky ligj dhe nga ligji nr. 8492 datë 27.5.1999 “Për të huajt”.

Neni 24
Klasifikimi i vendkalimeve kufitare

1. Vendkalimet kufitare sipas rëndësisë dhe veprimtarisë klasifikohen në vendkalime kufitare për komunikacion ndërkombëtar dhe vendkalime kufitare për komunikacion kufitar.

2. Veprimtaria në vendkalimet kufitare mund të fillojë dhe të ndërpritet përkohësisht ose në mënyrë të përhershme në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare.

3. Vendkalimet kufitare përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 25
Zona e kontrollit për kalimin e kufirit

1. Në çdo vendkalim kufitar ka zonë kontrolli për kalimin e kufirit.

2. Procedurat e kontrollit të kalimit të kufirit shtetëror kryhen brenda zonës së kontrollit. Në hyrje të saj vendosen shenja treguese.

3. Hapësira, regjimi i punës dhe procedurat në zonën e kontrollit të kalimit të kufirit shtetëror përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Rendit Publik.

Neni 26
Situatat e veçanta

Në rast të dendësimit të madh të trafikut, ngjarjeve të rënda ose forcave madhore, autoriteti vendor i Policisë Kufitare në bashkëpunim me autoritetin doganor dhe në marrëveshje me organin përkatës së shtetit fqinjë, përcakton masat për zgjidhjen e tyre me marrëveshje të përbashkëta.

Neni 27
Vendkalimet kufitare hekurudhore

Në vendkalimet kufitare hekurudhore, trenat ndërkombëtarë lejohet të ndalojnë vetëm në zonën e kontrollit të kalimit të kufirit shtetëror. Qëndrimi i tyre në vende ndërmjet vijës së kufirit

dhe zonës së kontrollit bëhet vetëm për shkak të forcës madhore. Në këtë rast personeli i trenit dhe ai hekurudhor janë të detyruar të njoftojnë menjëherë organet që veprojnë në zonën e kontrollit të kalimit të kufirit më të afërt.

Neni 28

Kontrolli i mjeteve të lundrimit dhe zbritja në tokë

1. Anija shqiptare ose e huaj i nënshtrohet kontrollit të kalimit të kufirit shtetëror dhe kapiteni është i detyruar t'i dorëzojë autoritetit të Policisë Kufitare të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

2. Kapiteni i anijes shqiptare ose të huaj në zonën e kontrollit të kalimit të kufirit shtetëror është i detyruar të njoftojë autoritetin e Policisë Kufitare për praninë në bord të individëve pa dokumente ose me dokumente të parregullta.

3. Ekuipazhi dhe udhëtarët e anijes, shqiptare ose të huaj, lejohet të zbresin në tokë vetëm pas përfundimit të procedurave të kontrollit të kalimit të kufirit shtetëror.

4. Kapitenit të anijes i ndalohet të marrë ose të zbresë në det të hapur larg brigjeve të Republikës së Shqipërisë persona të cilët nuk i janë nënshtuar kontrollit në vendkalimet kufitare, me përjashtim të rasteve kur kërkohet ndihmë për shkak të forcave madhore. Kur për shkaqe të ndryshme anija ankorohet jashtë zonës së kontrollit të kalimit të kufirit shtetëror, kapiteni i saj detyrohet të njoftojë menjëherë nëpërmjet kapitenerisë së portit organin më të afërt të Policisë Kufitare vendore.

5. Marinarët e huaj, që ndodhen në bordin e anijeve jo luftarake dhe që mbajnë flamur të huaj, mund të zbresin në port ose të bëjnë vizita në qytet ose në zona në afërsi të tij me kërkesën e kapitenit të anijes dhe me leje individuale të lëshuara nga autoriteti i Policisë Kufitare të portit.

Neni 29

Zbritja në tokë e udhëtarëve dhe e ekuipazhit

1. Pjesëtarët e ekuipazhit dhe udhëtarët e mjeteve ajrore, të vendit ose të huaja, lejohet të zbresin dhe të shkojnë në zonën e kontrollit të vendkalimeve kufitare me leje të autoritetit policor të kufirit. Nuk lejohet largimi nga zona e kontrollit (e përpunimit të avionit) deri në përfundim të procedurave të kontrollit të kalimit të kufirit.

2. Në rastet e situatave të jashtëzakonshme, kur ulja e avionit bëhet në aerodrome ku nuk ekziston sherbimi policor ose doganor, kapiteni i avionit njofton organin më të afërt të Policisë së Shtetit.

Neni 30

Kushtet për kryerjen e kontrollit

1. Subjektet shtetërore ose private, vendase ose të huaja, të cilat shfrytëzojnë portet, aeroportet dhe linjat e tjera të transportit, detyrohen të sigurojnë kushtet e nevojshme të kryerjes së procedurave normale të ushtrimit të kontrollit të kalimit të kufirit shtetëror.

2. Këto subjekte duhet të garantojnë deri në përfundim kryerjen e të gjitha procedurave të kontrollit të kalimit të kufirit shtetëror nga Policia Kufitare.

Neni 31

Ndërrimi i mjeteve të huaja dhe i ekuipazhit të tyre

Ndërrimi i mjeteve të huaja lundruese dhe i ekuipazheve të tyre, të cilat dislokohen në Republikën e Shqipërisë në bazë të marrëveshjeve të përbashkëta me shtetet e tjera, lejohet me autorizim të titullarit të institucionit shtetëror përkatës, por duke iu nënshtuar kontrollit të kalimit të kufirit shtetëror.

Neni 32

Mjetet lundruese të huaja

1. Mjetet lundruese të huaja ushtrojnë veprimtari turistike, sportive, studimore, kërkimore-shkencore dhe veprimtari të tjera të ngjashme në ujërat e brendshme dhe territoriale të Republikës së Shqipërisë pasi i janë nënshtruar kontrollit të kalimit të kufirit shtetëror.

2. Leja për ushtrimin e veprimtarisë jepet nga titullari i institucionit shtetëror qendror përkatës, ndërsa lejimi i lundrimit bëhet me dënimin dhe nën kontrollin e Policisë Kufitare vendore.

3. Në rastet e veprimtarive sportive ndërkombëtare lejohet kalimi tranzit i mjeteve lundruese, duke vënë më parë në dënimin organet e Policisë Kufitare vendore për kohën, numrin e mjeteve dhe itinerarin e lëvizjes.

4. Drejtuesit e mjeteve lundruese nuk lejohen të bregëzohen, të marrin ose të zbresin persona me ose pa dokumentet përkatëse, jashtë zonës së kontrollit kufitar ose atyre të lejuara nga Policia Kufitare për bregëzim.

5. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe në rastet e veprimtarive sportive me mjete ajrore.

Neni 33

Kalimi jashtë vendkalimeve kufitare

Lejimi i kalimit të kufirit jashtë vendkalimeve kufitare bëhet në raste të veçanta kur parashikohet me marrëveshje të përbashkëta me shtetet e tjera. Në këto raste kalimi i kufirit dhe punimet në vijën e kufirit kryhen me leje të posaçme të Drejtorisë Qendrore të Policisë Kufitare nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e saj. Leja e posaçme është e vlefshme vetëm për territorin ku kryhen punimet ose veprimtaritë e tjera të përbashkëta, sipas marrëveshjes.

Neni 34

Leja për të huajt për të mbajtur armë

1. Ushtarakët dhe punonjësit e policive të huaja dhe persona të tjerë që hyjnë ose qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë, për vizita zyrtare ose në bazë të marrëveshjeve të përbashkëta dhe që mbajnë armë, lejohen të hyjnë me leje të Drejtorit të Policisë Kufitare.

2. Leja u rikthehet autoriteteve të Policisë Kufitare në çastin kur dalin jashtë territorit shqiptar.

KREU VI SANKSIONET

Neni 35

Shkeljet administrative

Përbën kundërvajtje administrative:

a) shkelja e nenit 11 pika 2, e nenit 28 dhe e nenit 31 dhe dënohet me gjobë nga 10 000 lekë deri në 50000 lekë;

b) shkelja e nenit 23 pika 1 dhe 2, e nenit 15, e nenit 11 pika 1 dhe 3, e nenit 21 dhe e nenit 13 dhe dënohet me gjobë nga 1 000 deri në 5 000 lekë;

c) shkelja e nenit 29, e nenit 30 dhe e nenit 33 dhe dënohet me gjobë nga 5 000 deri 10 000 lekë.

Neni 36

Ekzekutimi dhe ankimi

1. Gjoha jepet nga autoriteti i policisë vendore të vendit, ku është kryer shkelja administrative.

2. Ankimi dhe ekzekutimi i gjobës bëhet në përputhje me ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”

3. Shtetasit e huaj mund të paguajnë gjobën edhe në valutë, sipas kursit ditor të këmbimit me lekun shqiptar.

Neni 37

Kthimi i të huajve që s’lejohet të hyjnë në Republikën e Shqipërisë

1. Në rastet kur një shtetas i huaj udhëton për në Republikën e Shqipërisë me avion, anije, tren ose mjet tjetër transporti dhe për arsye të përligjura nuk lejohet të hyjë në territorin shqiptar, shoqëria e udhëtimit është detyruar ta rikthejë në shtetin prej të cilit ka ardhur me shpenzimet e veta.

2. Në rast të përsëritjes së veprimeve të mësipërme, shoqëria e udhëtimit, përveç shpenzimeve të rikthimit, paguan edhe gjobë nga 10 000 deri 50 000 lekë.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 38

Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, dekreti nr.5222, datë 21.11.1974 “Për rregullat e zbritjes dhe të qëndrimit në tokë të personave, të ekuipazhit të anijeve të huaja në kohën që ndodhen në portet e Republikës së Shqipërisë”, ligji nr.8342, datë 6.5.1998 “Për policinë kufitare”, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 39

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2995, datë 4.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Rexhep Meidani**

L I G J Nr.8773, datë 23.4.2001

PËR TUBIMET

Në mbështetje të neneve 47, 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Liria e tubimeve dhe kufizimi i saj

1. Në Republikën e Shqipërisë çdo person ka të drejtë të organizojë dhe të marrë pjesë në tubime paqësore dhe pa armë.

2. Kjo e drejtë kufizohet vetëm në rast se rrezikohet sigurimi kombëtar, sigurimi publik, mbrojtja e rendit dhe parandalimi i krimit, ruajtja e shëndetit ose moralit, ose mbrojtja e të drejtave dhe e lirive të tjerëve.

Neni 2 **Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Organizator” kuptohet personi që organizon tubimin dhe persona të tjerë që japin ndihmesë në zhvillimin e tij.

2. “Person ndihmës për mbarrëvajtjen e tubimit” kuptohet personi që mbështet organizatorin dhe drejtuesin e tubimit.

3. “Sheshe dhe vendkalime publike” kuptohen sheshet, bulevardet, rrugët dhe çdo mjedis tjetër që shfrytëzohet lirisht për lëvizjen dhe qëndrimin e çdo individi.

4. “Shef i Komisarariatit të Policisë” është shefi i komisarariatit të policisë në territorin në të cilin zhvillohet tubimi.

5. “Tubime” kuptohen grumbullimet, manifestimet, mbledhjet dhe parakalimet me karakter paqësor dhe pa armë, në të cilat një grup personash shprehin kërkesat dhe pikëpamjet e tyre për probleme për të cilat janë të interesuar dhe përfshin edhe tubimet urgjente. Kur grupe njerëzish grumbullohen në mënyrë spontane dhe nuk cenojnë rendin publik, veprimtaria e tyre nuk përfshihet në përkufizimin e tubimit.

6. “Vend i hapur për publikun” është një vend në dispozicion të personave të tjerë, të cilët mund të vënë kushte për të lejuar ose jo hyrjen në të.

Neni 3 **Detyrat e Policisë së Shtetit**

1. Policia e Shtetit garanton dhe mbron të drejtën e çdo personi për të organizuar dhe marrë pjesë në tubime paqësore dhe pa armë. Ndalimi ose shpërndarja e një tubimi lejohet vetëm në rastet e parashikuara në këtë ligj.

2. Në çdo rast, zbatimi i masave për ndalimin dhe shpërndarjen e një tubimi paqësor e pa armë bëhet në mënyrë të shkallëzuar.

Neni 4 **Prania e medias**

1. Përfaqësuesit e medias kanë të drejtë të jenë të pranishëm gjatë tubimit dhe nuk mund të përjashtohen nga askush gjatë zhvillimit të tij.

2. Përfaqësuesit e medias duhet të jenë të pajisur me kartën e anëtarësisë së medias.

3. Prania e përfaqësuesve të medias gjatë tubimit u bëhet e ditur në çdo kohë forcave të policisë që ndjekin zhvillimin e tubimit.

KREU II **TUBIMET NË SHESHE DHE VENDKALIME PUBLIKE**

Neni 5 **Njoftimi i Policisë së Shtetit**

1. Në rast tubimi në sheshe ose vendkalime publike, organizatori dhe drejtuesi janë të detyruar të njoftojnë me shkrim shefin e komisarariatit të policisë jo më vonë se tri ditë para datës së zhvillimit të tubimit.

2. Njoftimi me shkrim duhet të përmbajë:
- a) identitetin dhe adresën e drejtuesit dhe të organizatorit të tubimit;
 - b) qëllimin e tubimit;
 - c) datën, vendin, orën e fillimit dhe të përfundimit të tubimit dhe itinerarin e tij (nëse ka të tillë);
 - ç) numrin e përafërt të pjesëmarrësve dhe numrin e personave ndihmës në mbarëvajtjen e tubimit;
 - d) personat që do të flasin në tubim.
3. Në rast se njoftimi me shkrim nuk i përmban elementet e parashikuar në pikën 2 të këtij neni, ai i kthehet për plotësim organizatorit dhe drejtuesit të tubimit, të cilët duhet ta riparaqesin atë të plotësuar jo më vonë se 24 orë para kohës kur do të zhvillohet tubimi.

Neni 6 Detyrimi i policisë

1. Shefi i Komisarariatit të Policisë, brenda 24 orëve nga marrja e kërkesës sipas pikës 2 të nenit 5 ose brenda 8 orëve nga marrja e kërkesës sipas pikës 3 të nenit 5 të këtij ligji, me vendim të arsyetuar duhet:
- a) t'i komunikojë organizatorit ose drejtuesit të tubimit ndalimet dhe kufizimet e mundshme ose kushtet e tjera, duke përfshirë edhe numrin e personave që do të ndihmojnë në mbarëvajtjen e tij;
 - b) t'u japë një kopje të urdhrat zyrtar për caktimin e oficerit të policisë që do të jetë përgjegjës për të ndihmuar e vëzhguar zhvillimin e tubimit.
2. Shefi i Komisarariatit të Policisë njofton me shkrim drejtuesin e pushtetit vendor dhe prefektin për zhvillimin e tubimit.

Neni 7 Tubimet urgjente

Kur ka rrethana urgjente, tubimi mund të zhvillohet pa respektuar afatin e parashikuar në nenin 5 të këtij ligji, po detyrimisht duhet të bëhet njoftimi me shkrim i cili përmban elementet e përcaktuara në nenin 5 pika 2 të këtij ligji, si dhe arsyen e urgjencës. Njoftimi duhet të bëhet menjëherë, po jo më vonë se 3 orë përpara kohës së zhvillimit të tubimit.

Neni 8 Ndalimi i zhvillimit të një tubimi

Kur ka arsye të motivuar se zhvillimi i një tubimi në një shesh ose vendkalim publik përbën një rrezik real për sigurinë kombëtare, sigurinë publike, parandalimin e krimit, mbrojtjen e shëndetit ose të moralit ose mbrojtjen e lirisë dhe të drejtave të tjerëve dhe ky rrezik nuk mund të ndalojë me masa më pak shtrënguese, shefi i komisarariatit të policisë mund të ndalojë zhvillimin e tubimit ose të vendosë për kohën dhe vendin e zhvillimit të tubimit.

Neni 9 Shpërndarja e një tubimi

1. Një tubim në një shesh ose vendkalim publik mund të shpërndahet nga forcat policore me uniformë, vetëm në rastet kur:
- a) mënyra e zhvillimit të tubimit është e tillë që mund të dëmtojë në mënyrë konkrete rendin publik dhe sigurinë e personave;
 - b) gjatë zhvillimit të tij kryhen krime;
 - c) ekziston një situatë emergjente që lidhet me sigurinë publike, kur vendi i zënë nga tubimi kërkohet nga shërbimet e emergjencës.

2. Oficeri i policisë, përgjegjës për të ndihmuar dhe vëzhguar zhvillimin e tubimit, mund të urdhërojë largimin e një grupi personash nga tubimi, në rast se mendon se rreziku shmanget me largimin e këtij grupi personash që pengojnë zhvillimin normal të tubimit. Në rast të kundërt, oficeri i policisë, përgjegjës për të ndihmuar dhe vëzhguar tubimin, urdhëron organizatorët, drejtuesit dhe pjesëmarrësit të ndërpresin tubimin dhe të largohen nga vendi.

Neni 10

Drejtuesi i tubimit dhe ndihmësit e tij

1. Drejtuesi i tubimit caktohet njëri nga organizatorët ose personat e tjerë që japin ndihmesë në realizimin e tubimit.

2. Drejtuesi dhe personat ndihmës duhet të jenë mbi moshën 18 vjeç. Personat ndihmës duhet të mbajnë në krahun e majtë një shirit të bardhë ku të jetë shkruar “PMT” (Përgjegjës për Mbarëvajtjen e Tubimit)

Neni 11

Të drejtat dhe detyrat e drejtuesit dhe të ndihmësve të tij

1. Drejtuesi i tubimit është përgjegjës për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e tubimit. Ai duhet të mbështesë policinë në ruajtjen e rendit, të vendosë për ndërprerjen, vazhdimin ose mbylljen e tubimit, të lejojë marrjen e fjalës, të ndërpresë oratorët në fjalën e tyre dhe të deklarojë mbylljen e fjalimeve ose të tubimit.

2. Drejtuesi i tubimit dhe ndihmësit e tij kanë autoritetin për t’u dhënë urdhra pjesëmarrësve në tubim, me qëllim ruajtjen e rendit publik.

3. Në rast se urdhrat e drejtuesit të tubimit nuk zbatohen nga pjesëmarrësit dhe rrezikohet mbarëvajtja e tubimit, drejtuesi duhet të mbyllë tubimin.

KREU III

TUBIME NË VENDE TË HAPURA PËR PUBLIKUN

Neni 12

Tubimet në vende të hapura për publikun

1. Tubimet në vende të hapura për publikun mbahen edhe pa njoftimin paraprak të policisë, sipas nenit 5 të këtij ligji.

2. Organizatorët e këtyre tubimeve mund të kërkojnë mbështetjen e policisë jashtë këtyre vendeve, për të mënjeluar çrregullimet gjatë ose pas zhvillimit të tubimit.

Neni 13

Personat që ndjekin tubimin

Drejtuesi i tubimit dhe organizatorët e tij vendosin se cilët persona do të ndjekin tubimin, përveç përfaqësuesve të medias të cilët, në asnjë rast, nuk mund të përjashtohen.

Neni 14

Urdhrat e drejtuesit të tubimit dhe ndihmësve të tij

1. Për zhvillimin dhe mbarëvajtjen normale të tubimit në vend të hapur për publikun, pjesëmarrësit në të janë të detyruar të ndjekin urdhrat e drejtuesit dhe të ndihmësve të tij.

2. Drejtuesi i tubimit mund të përjashtojë pjesëmarrës në tubim që prishin rregullin në të. Në raste të tilla drejtuesi mund të kërkojë edhe ndihmën e policisë për largimin e këtyre personave.

Neni 15

Prania e oficerit përgjegjës të policisë

Oficeri i policisë, përgjegjës për të vëzhguar zhvillimin e tubimit në vende të hapura për publikun, duhet të prezantohet tek drejtuesi i tubimit dhe të qëndrojë në një vend të përshtatshëm, të cilin duhet t'ia bëjë të ditur drejtuesit të tubimit.

Neni 16

Ndalimi dhe mbyllja e tubimit

Mbajtja e një tubimi në vende të hapura për publikun mund të ndalohet dhe të mbyllet, nëse ka filluar, kur:

- a) organizatori, drejtuesi ose personat ndihmës lejojnë hyrjen e pjesëmarrësve të cilët mbajnë armë;
- b) ka arsye të motivuara për të besuar se zhvillimi i tubimit do të bëhet i dhunshëm ose rebelues;
- c) ekziston rrezik për jetën ose shëndetin e pjesëmarrësve.

Neni 17

Tubimet në zonat private

1. Policia nuk mund të hyjë në zona private ku zhvillohen tubime pa lejen e drejtuesit të tubimit ose pronarit të saj, me përjashtim të rasteve flagrante për të ndaluar një rrezik të çastit për jetën dhe shëndetin e pjesëmarrësve në tubim.

2. Për këtë nen "zonë private" kuptohet vendi ku hyrja është e lejuar vetëm për një numër të caktuar personash, emrat e të cilëve njihen.

KREU IV NDALIMET

Neni 18

Ndalimi i mbajtjes së armëve

1. Organizatori, drejtuesit, personat ndihmës dhe pjesëmarrësit në një tubim, kudo ku zhvillohet ai, nuk lejohen të mbajnë armë edhe nëse kanë lejë për mbajtjen e tyre.

2. Organizatori, drejtuesit, personat ndihmës dhe pjesëmarrësit në një tubim ndalohen të mbajnë mjete ose instrumente të cilat gjatë përdorimit të tyre mund të shkaktojnë dëm për jetën dhe shëndetin e të tjerëve. Përjashtohen nga ky detyrim flamujt dhe pankartat.

Neni 19

Ndalimi i fshehjes së identitetit

Ndalohet pjesëmarrja në tubim me veshje të tilla ose përdorimi i sendeve të tjera me qëllim fshehjen e identitetit të personit.

Neni 20

Ndalimi i përdorimit të uniformës, shenjave ose simboleve

Në tubime të zhvilluara në sheshe ose vendkalime publike ose në vende të hapura për publikun, nga organizatori, drejtuesit, personat ndihmës dhe pjesëmarrësit, nuk lejohet përdorimi i uniformave, shenjave ose simboleve që u referohen shoqatave ose grupeve të cilat janë krijuar për të nxitur diskriminimin dhe dhunën për arsye raciale, etnike ose fetare.

KREU V
NDËRHYRJA E POLICISË SË SHTETIT

Neni 21

Regjistrimi i zërave dhe figurave

1. Në tubimet në sheshe e vendkalime publike ose në vende të hapura për publikun, policia mund të regjistrojë zëra, të filmojë ose të fotografojë vetëm në rast se ka arsye për të besuar së ekziston një rrezik i menjëhershëm për rendin dhe sigurinë publike.

2. Regjistrimet, filmimet dhe fotografitë duhet të asgjësohen menjëherë pas tubimit, në rast se nuk nevojiten:

- a) për nisjen e procedimit penal të pjesëmarrësve;
- b) për parandalim rreziku, kur besohet se personi i filmuar mund të kryejë në të ardhmen vepra penale në lidhje me tubimet.

Neni 22

Përgjyeshimi i pjesëmarrësve nga policia

1. Gjatë një tubimi, policia, me kërkesë të drejtuesit të tubimit ose kryesisht, mund të përgjyeshojë pjesëmarrës ose grupe pjesëmarrësish nga tubimet e zhvilluara në sheshe dhe vendkalime publike, kur janë përgjegjës për sjelljen që ndalohe sipas nenit 8 të këtij ligji.

2. Në këto raste policia mund të bëjë identifikimin e këtyre personave, kontrollin për armëmbajtje dhe u jep urdhër për largimin nga vendi ku zhvillohet tubimi.

Neni 23

Masat për shpërndarjen e një tubimi

1. Në të gjitha rastet e parashikuara në këtë ligj, kur duhet bërë shpërndarja e një tubimi, oficeri i policisë, përgjegjës për të ndihmuar dhe vëzhguar zhvillimin e tubimit, i jep urdhër organizatorëve, drejtuesit, personave ndihmës dhe pjesëmarrësve të ndërpresin tubimin dhe të largohen menjëherë nga vendi i zhvillimit të tubimit.

2. Në rast se pas tri thirrjeve të qarta nga ana e policisë për shpërndarje, pjesëmarrësit nuk largohen, oficeri i policisë urdhëron shpërndarjen e tubimit me forcë.

3. Në çdo rast përdorimi i forcës duhet të kufizohet përherë në minimum.

KREU VI
SANKSIONET

Neni 24
Sanksionet

Përbën kundërvajtje penale:

a) pjesëmarrja nga personat në tubime të ndaluara për t'u zhvilluar, sipas nenit 8 të këtij ligji dhe dënohet me gjobë nga 1000 deri në 10 000 lekë;

b) moszbatimi i urdhrave të policisë për shpërndarjen e tubimit sipas nenit 9 të këtij ligji dhe dënohet me gjobë nga 1000 deri në 10 000 lekë;

c) përdorimi i veshjeve ose i sendeve të tjera me qëllim fshehjen e identitetit të personit gjatë zhvillimit të një tubimi, sipas nenit 19 të këtij ligji dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj;

ç) përdorimi i shenjave ose simboleve që u referohen shoqatave ose grupeve të krijuara për të nxitur dhunën dhe diskriminimin për arsye raciale, etnike ose fetare, sipas nenit 20 të këtij ligji dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 25
Ankimi

Vendimi administrativ i dhënë nga shefi i komisariatit të policisë ose vendimet e dhëna nga oficeri përgjegjës për zhvillimin e tubimit janë të ankimueshme, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 26
Shfuqizimi

Ligji nr. 8145, datë 11.9.1996 “Për të drejtën e tubimeve” shfuqizohet.

Neni 27
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2996, datë 4.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Rexhep Meidani

L I G J
Nr.8774, datë 23.4.2001

PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS NR.182 “FORMAT MË TË KËQIA
TË PUNËS SË FËMIJËVE, 1999” TË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE
TË PUNËS”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Neni 1

Ratifikohet “Konventa nr.182 “Format më të këqia të punës së fëmijëve, 1999” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2997, datë 4.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Rexhep Meidani

KONVENTA 182

Konventa lidhur me Ndalimin e Formave më të Këqia të Punës së Fëmijëve dhe veprimin e menjëhershëm për eliminimin e tyre.

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës,

E thirrur në Gjenevë nga Këshilli Administrativ i Zyrës Ndërkombëtare të Punës, dhe e mbledhur në sesionin e saj të 87-të më 1 Qershor 1999, dhe

Duke konsideruar nevojën e miratimit të instrumenteve të rinj për ndalimin dhe eliminimin e formave më të këqia të punës së fëmijëve, si prioritetin kryesor për veprimin kombëtar dhe ndërkombëtar, duke përfshirë bashkëpunimin dhe ndihmën ndërkombëtare, për të plotësuar Konventën dhe Rekomandimin lidhur me moshën minimale për pranimin në punë, 1973, të cilat mbeten instrumentet themelore për punën e fëmijëve, dhe

Duke konsideruar se eliminimi efektiv i formave më të këqia të punës së fëmijëve kërkon veprim të menjëhershëm dhe të gjithanshëm, duke marrë në konsideratë rëndësinë e arsimimit falas dhe nevojën për të larguar fëmijët nga të gjitha këto lloj pune dhe të sigurojë rehabilitimin dhe integrimin e tyre social duke pasur parasysh nevojat e familjeve të tyre, dhe

Duke kujtuar rezolutën lidhur me eliminimin e punës së fëmijëve të miratuar nga Konferenca Ndërkombëtare e Punës në sesionin e saj të 83-të më 1996, dhe

Duke pranuar se puna e fëmijëve ekziston, në një masë të madhe, për shkak të varfërisë dhe se zgjidhja afatgjatë varet nga rritja e qëndrueshme ekonomike që çon në progresin social, veçanërisht në zbutjen e varfërisë dhe arësimin për të gjithë, dhe

Duke kujtuar Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me 20 Nëntor 1989, dhe

Duke kujtuar Deklaratën e ILO-s mbi të Drejtat dhe Liritë Themelore në Punë dhe Follow-up-in e saj, miratuar nga Konferenca Ndërkombëtare e Punës në sesionin e saj të 86-të më 1998, dhe

Duke kujtuar se disa nga format më të këqia të punës së fëmijëve trajtohen nga instrumente të tjerë ndërkombëtare, veçanërisht nga Konventa Puna e Detyruar, 1930, dhe nga Konventa Plotësuese e Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e Skllavërisë, Tregëtia e Skllavërve, dhe Institucionet dhe Praktikrat e Ngjashme me Skllavërinë, 1956, dhe

Pasi vendosi mbi miratimin e disa propozimeve lidhur me punën e fëmijëve, e cila është pika e 4-të në rendin e ditës së sesionit, dhe

Pasi vendosi që këto propozime të marrin formën e një konvente ndërkombëtare:

miraton këtë ditë të shtatëmbëdhjetë të Qershorit të vitit njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë Konventën e mëposhtëme, e cila mund të quhet Konventa Format më të Këqia të Punës së Fëmijëve, 1999.

Neni 1

Çdo anëtar i cili ratifikon këtë Konventë duhet të marrë masa të menjëhershme dhe efektive për të siguruar ndalimin dhe eliminimin e formave më të këqia të punës së fëmijëve, si një çështje urgjente.

Neni 2

Në kuptim të kësaj Konvente, termi “fëmijë” nënkupton të gjithë personat nën moshën 18 vjeç.

Neni 3

Në kuptim të kësaj Konvente, termi “format më të këqia të punës së fëmijëve” nënkupton:

a - të gjitha format e skllavërisë ose praktikave të ngjashme me të, si shitja dhe trafikimi i fëmijëve, robëria dhe bujkrobëria për shkak të borxheve dhe puna e detyruar apo e detyrueshme, duke përfshirë rekrutimin e detyruar apo të detyrueshëm të fëmijëve për t'i angazhuar në konflikt të armatosur;

b - përdorimi, sigurimi ose ofrimi i fëmijës për prostitucion, për prodhimin e materialeve pornografike ose për shfaqje pornografike;

c- përdorimi, sigurimi ose ofrimi i fëmijës për veprimtari të paligjshme, veçanërisht për prodhimin dhe trafikimin e narkotikëve, sipas përcaktimit në traktatet përkatëse ndërkombëtare;

d- puna e cila, nga natyra ose rrethanat në të cilat kryhet, mund të dëmtojë shëndetin, sigurinë ose moralin e fëmijëve.

Neni 4

1. Llojet e punëve të përmendura në nenin 3 (d) duhet të përcaktohen nga aktet ligjore ose nënligjore të vendit ose nga autoritetet kompetente, pas konsultimit me organizatat e interesuara të punëtorëve dhe punëdhënësve, duke marrë në konsideratë standardet përkatëse ndërkombëtare, veçanërisht paragrafet 3 he 4 të Rekomandimit, 1999, Format më të Këqia të Punës së Fëmijëve.

Neni 5

Çdo anëtar duhet, pas konsultimit me organizatat e punëtorëve dhe punëdhënësve, të krijojë ose përcaktojë mekanizmin e përshtatshëm për të monitoruar zbatimin e dispozitave që i japin fuqi kësaj Konvente.

Neni 6

1. Çdo anëtar duhet të hartojë dhe zbatojë programe veprimi për eliminimin, si prioritet, të formave më të këqia të punës së fëmijëve.

2. Këto programe veprimi duhet të hartohen dhe zbatohen në konsultim me institucionet përkatëse shtetërore dhe organizatat e punëtorëve dhe punëdhënësve, duke marrë në konsideratë pikpamjet e grupeve të tjera të interesuara, kur paraqitet rasti.

Neni 7

1. Çdo anëtar duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zbatimin efektiv dhe hyrjen në fuqi të dispozitave që i japin efekt kësaj Konvente duke përfshirë dispozitat dhe zbatimin e sanksioneve penale ose, kur është e nevojshme, sanksione të tjera.

2. Çdo anëtar duhet, duke marrë në konsideratë rëndësinë e arsimit në eliminimin e punës së fëmijëve, të marrë masa efektive dhe në një afat të caktuar për:

a- të ndaluar angazhimin e fëmijëve në format më të këqia të punës së fëmijëve;

b- të siguruar ndihmën direkte të nevojshme dhe të përshtatshme për largimin e fëmijëve nga format më të këqia të punës së fëmijëve, si dhe për rehabilitimin e integrimin social të tyre;

c- të siguruar akses në arsimin bazë falas, dhe, kur është e mundshme dhe e nevojshme, kualifikimin profesional, për të gjithë fëmijët e larguar nga format më të këqia të punës së fëmijëve;

d- të identifikuar dhe kontaktuar direkt me fëmijët që ndodhen në rrezik të veçantë; dhe

e- të marrë në konsideratë situatën e veçantë të vajzave.

3. Çdo Anëtar duhet të caktojë autoritetin kompetent përgjegjës për zbatimin e dispozitave që i japin fuqi kësaj Konvente.

Neni 8

Anëtarët duhet të marrin masat e nevojshme që të ndihmojnë njeri-tjetrin për t'iu dhënë fuqi dispozitave të kësaj Konvente nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ose ndihmës, duke përfshirë mbështetjen për zhvillimin social dhe ekonomik, programet për eliminimin e varfërisë, si dhe të arsimit për të gjithë.

Neni 9

Ratifikimi zyrtar i kësaj Konvente duhet t'i komunikohet për regjistrim Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës.

Neni 10

1. Kjo Konventë do të jetë e detyrueshme vetëm për ata Anëtarë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës ratifikimet e të cilëve janë regjistruar te Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës.

2. Ajo do të hyjë në fuqi 12 muaj pas datës në të cilën ratifikimet e dy Anëtarëve janë regjistruar tek Drejtori i Përgjithshëm.

3. Pas kësaj, kjo Konventë do të hyjë në fuqi për çdo Anëtar 12 muaj pas datës në të cilën është regjistruar ratifikimi i saj.

Neni 11

1. Anëtari që ka ratifikuar këtë Konventë mund ta denoncojë atë, pas kalimit të dhjetë vjetëve nga data në të cilën Konventa hyn në fuqi për herë të parë, me anën e një akti që i komunikohet për regjistrim Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës. Ky denoncim nuk do të hyjë në fuqi deri në një vit pas datës në të cilën ai është regjistruar.

2. Çdo Anëtar që ka ratifikuar këtë Konventë dhe i cili nuk e ushtron të drejtën e denoncimit të parashikuar në këtë nen brenda një viti pas mbarimit të periudhës 10 vjeçare të parashikuar në paragrafin e mësipërm, nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë për një periudhë tjetër 10 vjeçare dhe, pas kësaj, mund ta denoncojë këtë Konventë në mbarim të çdo periudhe 10 vjeçare, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen.

Neni 12

1. Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës njofton të gjithë Anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për regjistrimin e të gjitha ratifikimeve dhe akteve të denoncimit që komunikohen nga Anëtarët e Organizatës.

2. Kur njofton Anëtarët e Organizatës për regjistrimin e ratifikimit të dytë, Drejtori i Përgjithshëm duhet t'u kujtojë Anëtarëve të Organizatës datën në të cilën Konventa do të hyjë në fuqi.

Neni 13

Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës duhet t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për regjistrimin, në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, të gjitha veçoritë e ratifikimeve dhe akteve të denoncimit që janë regjistruar nga Drejtori i Përgjithshëm, në përputhje me dispozitat e neneve të mësipërm.

Neni 14

Këshilli Drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës duhet t'i paraqesë Konferencës së Përgjithshme, sa herë që e gjykon të nevojshme, një raport mbi zbatimin e kësaj Konvente, si dhe të shqyrtojë mundësinë e vendosjes në rendin e ditës së Konferencës të çështjes së ndryshimit të pjesshëm apo të plotë të saj.

Neni 15

1. Në rastin kur Konferenca miraton një konventë të re, që ndryshon pjesërisht ose plotësisht këtë konventë, përveç kur konventa e re parashikon ndryshe:

a) ratifikimi nga një anëtar i konventës së re prezumon, pavarësisht nga kërkesa e nenit 11 më sipër denoncimin e menjëhershëm të kësaj konvente, nëse dhe kur konventa e re hyn në fuqi.

b) nga data e hyrjes në fuqi të konventës së re, kjo konventë do të pushojë së qeni e hapur për ratifikim nga Anëtarët.

2. Kjo Konventë, në çdo rast, do të mbetet në fuqi në formën dhe përmbajtjen e saj për të gjithë ata Anëtarë që kanë ratifikuar konventën e re.

Neni 16

Versionet frengjisht dhe anglisht të tekstit të kësaj Konvente kanë fuqi të barabartë.

L I G J

Nr.8775, datë 23.4.2001

PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS NR.131, DATË 6.6.1970 TË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS “CAKTIMI I PAGËS MINIMALE””

Në mbështetje të neneve 47, 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I :

Neni 1

Ratifikohet “Konventa nr.131, datë 6.6.1970 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Caktimi i pagës minimale””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2998, datë 4.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Rexhep Meidani**

KONVENTA NR. 131

Konventa lidhur me Caktimin e Pagës Minimale, me Referencë të veçantë për Vendet në Zhvillim

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës,

E thirrur në Gjenevë nga Këshilli Drejtues i Zyrës Nderkombëtare të Punës dhe e mbledhur në sesionin e saj të pesëdhjetë e katër, më 3 Qershor 1970, dhe

Duke vërejtur kushtet e Konventës, 1928, Metodat e Caktimit të Pagës Minimale dhe të Konventës 1951, Shpërblimi i Barabartë, të cilat janë ratifikuar nga shumica e Anëtarëve, si dhe të Konventës, 1951, Metodat e Caktimit të Pagës Minimale (Bujqësi), dhe

Duke marrë në konsideratë që kjo Konventë ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e grupeve të disfavorizuara të rrogëmarrësve, dhe

Duke marrë në konsideratë se ka ardhur koha që të miratohet një instrument tjetër që të plotësojë këtë Konventë dhe të sigurojë mbrojtjen e pagëmarrësve kundrejt pagave padrejtësisht të ulta, që, ndërsa për një zbatim të gjerë, i kushton vëmendje të veçantë nevojave të vendeve në zhvillim, dhe

Pasi ka vendosur mbi miratimin e disa propozimeve, lidhur me metodat e caktimit të pagës minimale dhe çështjet që lidhen me të, me referencë të veçantë për vendet në zhvillim, e cila është pika e pestë e axhendës së sesionit dhe

Pasi ka vendosur që këto propozime të marrin formën e një Konvente ndërkombëtare miraton në këtë ditë të njëzetë e dytë të Qershorit të vitit njëmijë e nëntëqintë e shtatëdhjetë, Konventën e mëposhtme, e cila mund të quhet Konventa për Caktimin e Pagës Minimale, 1970:

Neni 1

1. Çdo anëtar i Organizatës Ndërkombëtare të Punës, i cili ratifikon këtë Konventë, angazhohet të krijojë një sistem të pagës minimale, i cili të mbrojë të gjitha grupet e rrogëmarrësve, kushtet e punësimit të të cilëve janë të tilla që kërkojnë mbrojtje të përshtatëshme.

2. Autoriteti kompetent në secilin vend duhet, në marrëveshje ose pas konsultimit të plotë me organizatat përfaqësuese të interesuara të punëtorëve dhe të punëmarrësve, ku këto organizata ekzistojnë, të përcaktojë grupet e rrogëmarrësve që duhen mbrojtur.

3. Çdo Anëtar, i cili ratifikon këtë Konventë, duhet të listojë, në raportin e parë mbi zbatimin e Konventës, që paraqitet sipas nenit 22 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, çdo grup të pagëmarrësve të cilët mund të mos jenë mbrojtur sipas këtij Neni, duke dhënë arsyet e mosmbrojtjes së tyre, dhe të deklarojë në raportet e ardhëshme pozicionin e legjislacionit dhe praktikës në lidhje me grupet e pambrojtura, dhe masën në të cilën i është dhënë fuqi ose është propozuar për t'i dhënë fuqi Konventës lidhur me këto grupe.

Neni 2

1. Pagat minimale duhet të kenë fuqinë e ligjit dhe nuk duhet të jenë objekt i uljeve dhe personi ose personat që nuk zbatojnë kuotat e caktuara duhet t'u nënshtrohen sanksioneve penale ose sanksioneve të tjera.

2. Me rezervën e dispozitës së paragrafit 1 të këtij Neni, liria e negociatave kolektive duhet të respektohet plotësisht.

Neni 3

Elementët që duhen marrë në konsideratë për përcaktimin e nivelit të pagave minimale duhet, për aq sa është e mundur dhe e përshtatëshme në lidhje me praktikën dhe kushtet e vendit, të përfshijnë:

a) nevojat e punëtorëve dhe të familjeve të tyre, duke marrë në konsideratë nivelin e përgjithshëm të pagave në vend, koston e jetesës, përfitimet nga mbrojtja shoqërore dhe standartet relative të jetesës të grupeve të tjera shoqërore;

b) faktorët ekonomikë, duke përfshirë kërkesat e zhvillimit ekonomik, nivelet e prodhimit, si dhe dëshirën për arritjen dhe ruajtjen e një niveli të lartë punësimi.

Neni 4

1. Çdo Anëtar që ratifikon këtë Konventë duhet të krijojë dhe/ose të mbajë metoda, në përputhje me kushtet dhe kërkesat e vendit, me anën e të cilave pagat minimale për grupet e rrogëmarrësve të mbrojtur sipas Nenit 1, mund të caktohen dhe përmirësohen herë pas here.

2. Në përputhje me krijimin, funksionimin dhe përmirësimin e këtyre metodave, duhet të nxirren dispozita për konsultimin me organizatat përfaqësuese të punëtorëve dhe punëmarrësve të interesuar, ose në mungesë të këtyre organizatave, me përfaqësuesit e punëtorëve dhe punëdhënësve të interesuar.

3. Në çdo rast që është i përshtatshëm për natyrën e metodave të caktimit të pagës minimale, duhet të nxirren gjithashtu dispozita për pjesëmarrjen direkt në zbatimin e tyre të:

a) përfaqësuesve të organizatave të interesuara të punëtorëve dhe të punëdhënësve, ose në mungesë të tyre, të përfaqësuesve të punëtorëve dhe punëdhënësve të interesuar, mbi bazën e brazilisë;

b) personave kompetente për të përfaqësuar interesat e përgjithshme të vendit dhe të caktuar pas konsultimit me organizatat përfaqësuese të punëtorëve dhe punëdhënësve të interesuar, ku këto organizata ekzistojnë dhe ky konsultim në përputhje me legjislacionin ose praktikën e vendit.

Neni 5

Për të siguruar zbatimin efektiv të dispozitave që lidhen me pagën minimale, duhet të merren masat e duhura, si inspektimi adekuat i përforcuar me masa të tjera të nevojshme.

Neni 6

Kjo Konventë nuk do të prezumohet që ndryshon çdo Konventë në fuqi.

Neni 7

Ratifikimi zyrtar i kësaj Konvente duhet t'i komunikohet për regjistrim Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës.

Neni 8

1. Kjo Konventë është e detyrueshme vetëm për ata Anëtarë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, të cilët e kanë regjistruar ratifikimin e saj te Drejtori i Përgjithshëm.

2. Ajo hyn në fuqi 12 muaj pas datës së regjistrimit të ratifikimit të saj nga dy Anëtarë tek Drejtori i Përgjithshëm.

3. Pas kësaj Konvente do të hyjë në fuqi për çdo Anëtar 12 muaj pas datës në të cilën është regjistruar ratifikimi i saj.

Neni 9

1. Anëtari që ka ratifikuar këtë Konventë mund ta denoncojë atë pas kalimit të dhjetë vjetëve nga dita e hyrjes së saj në fuqi për herë të parë me anën e një akti që i komunikohet për regjistrim Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës. Ky denoncim do të hyjë në fuqi pas një viti nga dita e regjistrimit të tij.

2. Çdo Anëtar i cili ka ratifikuar këtë Konventë dhe i cili nuk e ushtron të drejtën e denoncimit të parashikuar në këtë Nen, brenda një viti pas kalimit të afatit 10-vjeçar të përmendur në paragrafin e mësipërm, do të jetë i detyruar për një afat tjetër 10 vjeçar, dhe pas këtij afati mund të denoncojë këtë Konventë pas kalimit të çdo afati 10 vjeçar, në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë Nen.

Neni 10

1. Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës duhet të njoftojë të gjithë Anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për të gjitha ratifikimet dhe denoncimet që i komunikohen atij nga Anëtarët e Organizatës.

2. Kur njofton Anëtarët e Organizatës për regjistrimin e ratifikimit të dytë që i komunikohet atij, Drejtori i Përgjithshëm duhet t'ju bëjë të ditur Anëtarëve të Organizatës datën në të cilën Konventa hyn në fuqi.

Neni 11

Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës duhet t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për regjistrim sipas Nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, të gjitha veçoritë e ratifikimeve dhe akteve të denoncimeve të regjistruara nga ai, në përputhje me dispozitat e Nenit të mësipërm.

Neni 12

Këshilli Drejtues i Organizatës Ndërkombëtare të Punës duhet t'i paraqesë, në një kohë që e gjykon të nevojshme, Konferencës së Përgjithshme një raport për zbatimin e kësaj Konvente dhe duhet të shqyrtojë nëse mund të vendoset në axhendën e Konferencës çështja e ndryshimit të pjesshëm apo të plotë të saj.

Neni 13

1. Kur Konferenca miraton një Konventë të re, duke ndryshuar këtë Konventë pjesërisht apo tërësisht, atëherë përveç kur Konventa e re parashikon ndryshe:

a) Ratifikimi nga një Anëtar i një Konvente të re që ndryshon këtë Konventë sjell denoncimin e menjëhershëm të kësaj të fundit, pavarësisht nga dispozitat e Nenit 9 më sipër, nëse dhe kur Konventa e re hyn në fuqi.

b) Nga data kur Konventa e re që ndryshon këtë Konventë hyn në fuqi, kjo e fundit pushon së qeni e hapur për ratifikim nga Anëtarët.

2. Kjo Konventë do të mbetet, në fuqi në çdo rast, në formën dhe përmbajtjen e saj aktuale për ata Anëtarë të cilët e kanë ratifikuar atë, por nuk kanë ratifikuar Konventën që e ndryshon atë.

Neni 14

Tekstet frengjisht dhe anglisht të kësaj Konvente kanë fuqi të barabartë.

V E N D I M

Nr. 245, datë 20.4.2001

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 418, DATË 10.6.1996, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E NORMAVE TË VESHMBATHJES SË USHTARAKËVE TË STRUKTURAVE TË MINISTRISË SË MBROJTJES"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr. 7496, datë 3.7.1991 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 418, datë 10.6.1996, të Këshillit të Ministrave bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, në pasqyrat 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 8 bëhen ndryshimet e përcaktuara sipas pasqyrave me shënimet përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Pas shkronjës "d" të pikës 2, shtohen shkronjat "dh" dhe "e" me përmbajtjet respektive:

"dh) Përdorimin e ndihmave të materialeve të veshmbathjes, të dhuruara nga dhurues të ndryshëm brenda strukturës së normave ose mbi normë, për efektivat dhe punonjësit e sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes."

"e) Seleksionimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të uniformave dhe të materialeve të tjera të veshmbathjes, të cilat për shkak të konsumit fizik e "moral", nuk gjejnë përdorim të mëtejshëm."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

PASQYRA 1

NDRYSHIMET NË NORMËN NR. 1 TË VESHMBATHJES PËR OFICERË

Nr	Emërtimi i materialit	Njësia Matjes	Sasia	Ndryshim afati përdorimi (vite)		Ndryshim afati norme (vite)	
				është bëhet	hiqet shtohet		
1.	Xhup me veshje të ngrohtë a) për oficerët e shtabeve të brigadave e lartë	copë	1	5	4		
2.	Rrip mesi: a) për oficerët e shtabeve të brigadave e lartë	copë	1	3	5		
	b) për komandant batalioni e poshtë	copë	1	2	3		
3.	Kostum stërvitjeje dimëror (kapele, xhaketë, pantallona) kamuflazhi: a) për oficerët e shtabeve të brigadave e lartë.	kompl.	1	4	2		
	b) për komandant batalioni e poshtë.	kompl.	1	2	1		
4.	Kostum stërvitjeje veror (kapele, xhaketë, pantallona) kamuflazhi: a) për oficerët e shtabeve të brigadave e lartë	kompl.	1	3	2		
5.	Çizme gome: a) për oficerët e shtabeve të brigadave e lartë	palë	1	4	-	4	
	b) për komandant batalioni e poshtë.	palë	1	2	3		
6.	Çantë dokumentash	copë	1	6	-	6	
7.	Doreza meshini me gëzof	palë	1	5	8		
8.	Pulovër	copë	1	2	3		
9.	Bluzë trikotazhi	copë	2	-	2		2

Në shënimet për normën nr.1 shtohen pikat:

10. Për artikujt xhup me veshje të ngrohtë, pelerinë shiu, kostum stërvitjeje (dimëror e veror) këpucë stërvitjeje me qafa, kostum sportiv, këpucë atlete dhe çorape, afatet e përdorimit llogariten nga momenti i furnizimit, pavarësisht nga e drejta dhe rradha e furnizimit, sipas normës. Afatet e përdorimit mund të jenë më të larta por jo më të ulta se norma.

11. Për artikujt: çantë dokumentesh e çizme gome, të cilat hiqen nga norma, autorizimet dhe të drejtat e prapambetura të paekzekutuara nuk likuidohen (jepen), pavarësisht nga e drejta e furnizimit që u ka lindur kuadrove sipas normës së mëparshme.

PASQYRA 2
NDRYSHIMET NË NORMËN NR. 2 TË VESHMBATHJES PËR NËNOFICERË

Nr	Emërtimi i materialit	Njësia e matjes	Sasia	Ndryshim afati përdorimi (vite)		Ndryshim afati norme (vite)	
				është	bëhet	hiqet	shtohet
1.	Xhup me veshje të ngrohtë a) për nënoficerët e tjerë	copë	1	5	4		
2.	Pelerinë ose mushama shiu a) për nënoficerët e karrierës	copë	1	2	3		
3.	Rrip mesi a) për nënoficerët e karrierës b) për nënoficerët e tjerë	copë copë	1 1	2 3	3 5		
4.	Kostum stërvitjeje dimëror (kapele, xhaketë, pantallona) kamuflazh: a) për nënoficerët e karrierës b) për nënoficerët e tjerë	kompl. kompl.	1 1	2 6	1 3		
5.	Kostum stërvitjeje veror (kapele, xhaketë, pantallona) kamuflazhi: b) Për nënoficerët e tjerë	kompl.	1	4	3		
6.	Çizme gome: a) për nënoficerët e karrierës b) për nënoficerët e tjerë	palë palë	1 1	2 5	3 -	5	
7.	Çantë dokumentesh	copë	1	5	-	5	
8.	Këpucë stërvitjeje me qafa: b) për nënoficerët e tjerë	palë	1	4	3		
9.	Pulovër	copë	1	2	3		
10.	Bluzë trikotazhi	copë	2	-	2		2
11.	Doreza meshini me gëzof	palë	1	5	8		

Në shënimet për normën nr.2 shtohen pikat:

6. Për nënoficerët e orkestrës frymore të ushtrisë kostumi i punës terital (një kapele, një xhaketë, dy palë pantallona) afati i përdorimit është 1 (një) komplet në 3 vjet.

7. Për artikujt: xhup me veshje të ngrohtë, pelerinë shiu, kostum stërvitjeje (dimërore e veror) këpucë stërvitjeje me qafa, kostum sportiv, këpucë atletike dhe çorape, afatet e përdorimit llogariten nga momenti i furnizimit, pavarësisht nga e drejta dhe rradha e furnizimit sipas normës. Afatet e përdorimit mund të jenë më të larta, por jo më të ulëta se norma.

8. Për artikujt: çantë dokumentesh e çizme gome, të cilat hiqen nga norma, autorizimet dhe të drejtat e prapambetura të paekzekutuara nuk likuidohen (jepen), pavarësisht nga e drejta e furnizimit që u ka lindur kuadrove sipas normës së mëparshme.

PASQYRA 3
NDRYSHIMET NË NORMËN NR. 3 TË VESHMBATHJES PËR OFICERËT DHE
NËNOFICERËT E POLICISË USHTARAKE

Nr	Emërtimi i materialit	Njësia e matjes	Sasia	Ndryshim afati përdorimi (vite)		Ndryshim afati norme (vite)	
				është bëhet	hiqet	shtohet	
1.	Pardesy	copë	1	4	3		
2.	Kostum pune terital (një kapele, një xhaketë, dy palë pantallona)	kompl.	1	3	2		
3.	Pulovër	copë	1	2	3		
4.	Kostum stërvitjeje dimëror (kapele, xhaketë, pantallona) kamuflazhi,	kompl.	1	8	2		
5.	Kostum stërvitjeje veror (kapele, xhaketë, pantallona) kamuflazhi	kompl.	1	6	1		
6.	Këpucë stërvitjeje me qafa	palë	1	6	1		
7.	Çantë krahëqafë	copë	1	-	6	-	6
8.	Doreza meshini me gëzof	palë	1	4	8		
9.	Bluzë trikotazhi	copë	2	-	2	-	2
10.	Çizme gome	palë	1	-	3	-	3

Shënim:

1. Për gratë oficere e nënoficere në vend të një pale pantallona mund t'u jepet një fund.
2. Kuadrot ushtarakë që transferohen nga një lloj force në një lloj tjetër force, pajisen me uniformën e re që mban reparti ku transferohet. Shënimi në kartelën personale bëhet sipas datës që i takon data e furnizimit.
3. Për oficerët dhe nënoficerët që dalin në pension dhe atyre që dalin në lirim, për arsye shëndetësore ose që kalojnë në punë në organet shtetërore, në vend të një pardesyje, të një kostumi dhe të këmishave të uniformës ushtarakë që u takon në vitin e fundit ose të parafundit, t'u jepet veshmbathje civile (një pardesy, një kostum dhe dy këmisha).
4. Oficerët dhe nënoficerët që dërgohen jashtë shtetit për kualifikim apo nevoja të tjera pune, në vend të kostumit të punës, pardesysë ose këmishave të verës, për llogari të të furnizimit të radhës mund t'u jepet veshmbathje civile (një pardesy, një kostum dhe dy këmisha).
5. Oficerët që emërohen për herë të parë, furnizohen me veshëmbathje komplet, sipas normës.
6. Nënoficerët që merren në punë për herë të parë, fillimisht furnizohen vetëm me një kostum stërvitjeje veror ose dimëror sipas stinës, këpucë stërvitjeje dhe rrip mesi. Pjesët e tjera të uniformës u jepen pasi të jenë marrë në provë se është miratuar marrja në punë, si dhe është lidhur kontrata. Nënoficerët që largohen vetë nga puna të çdëmojnë vleftën e mbetur të veshmbathjes që është furnizuar.
7. Inspektorët e Qarkullimit Rrugor e të MNZ-së të cilët përfitojnë veshje material inventar/reparti (xhaketë lëkure, pantallona lëkure, doreza meshini etj) afatet e përdorimit të xhupave me veshje të ngrohtë dhe të dorezave të meshinit u zgjaten dhe 2 (dy) vjet.
8. Sasia e spalinave të gradave, shenjave dalluese, dekoracioneve etj., si dhe afati i përdorimit të tyre do të jetë sipas llojit të uniformës dhe afatit të përdorimit të saj.
9. Norma e veshmbathjes nr. 3 është e njëjtë për oficerët dhe nënoficerët e Policisë Ushtarakë për të gjitha nivelet.
10. Për artikujt xhup me veshje të ngrohtë, kostum stërvitjeje (veror e dimëror) këpucë stërvitjeje me qafa, kostum sportiv, këpucë atletike e çorape, afatet e përdorimit llogariten nga momenti i furnizimit, pavarësisht nga e drejta dhe radha e furnizimit sipas normës.

11. Shënimet në normën e mëparëshme (pikat 1-4) shfuqizohen.

PASQYRA 4
NDRYSHIMET NË NORMËN NR. 4 TË VESHMBATHJES PËR NËNOFICERËT E
KARRIERËS TË AKADEMISË SË KAPTERRËVE

Nr	Emërtimi i materialit	Njësia e matjes	Sasia	Ndryshim afati përdorimi (vite)		Ndryshim afati norme (vite)	
				është	bëhet	hiqet	shtohet
1.	Xhup me veshje të ngrohtë	copë	1	2	3		
2.	Mushama shiu ose pelerinë	copë	1	2	3		
3.	Çizme gome	palë	1	2	3		
4.	Çantë krahëqafë	copë	1	4	6		
5.	Çantë shpine	copë	1	4	5		
6.	Doreza meshini	palë	1	5	8		
7.	Lugë gjelle	copë	1	1	2		
8.	Bluzë trikotazhi	copë	2	-	2	-	2
9.	Pulovër	copë	1	2	3		

Në shënimet për normën nr.4 bëhen këto rregullime:

Pika nr. 1 riformulohet: Materialet e veshmbathjes, afati i përdorimit të të cilave përputhet me kohën e vazhdimet të studimeve, trajtohen si pronë veti dhe shkarkohen nga llogaria materiale, pas plotësimit të afateve të përdorimit. Administrimi i këtyre materialeve bëhet edhe me kartelën personale.

Me mbarimin e studimeve, kapterrave u jepen me vete me fletë shoqërimi të gjitha materialet e tjera.

PASQYRA 5
NDRYSHIMET NË NORMËN NR. 5 TË VESHMBATHJES PËR STUDENTËT E AKADEMIVE
USHTARAKE

Nr	Emërtimi i materialit	Njësia e matjes	Sasia	Ndryshim afati përdorimi (vite)		Ndryshim afati norme (vite)	
				është	bëhet	hiqet	shtohet
1.	Bluzë trikotazhi	copë	3	-	3	-	3
2.	Rrip pantallonash	copë	1	2	3	-	-
3.	Çizme gome	palë	1	-	3	-	3

Në shënimet për normën nr. 5 bëhen këto rregullime:

1. Pika 1 riformulohet: Materialet e veshmbathjes, afati i përdorimit të të cilave përputhet me kohën e studimit të studentëve, trajtohen si pronë veti dhe shkarkohen nga llogaria materiale pas plotësimit të afateve të përdorimit. Administrimi i këtyre materialeve, gjatë kohës së shërbimit ushtarak (studimet), bëhet edhe me kartelë personale.

2. Shtohet pika 9: në vend të këmishave të verës, studentëve mund t'u jepen bluza trikotazhi.

PASQYRA 6
NDRYSHIMET NË NORMËN NR. 6 TË VESHMBATHJES PËR USHTARAKËT
(PËRJASHTUAR FLOTËN DETARE)

Nr	Emërtimi i materialit	Njësia e matjes	Sasia	Ndryshim afati përdorimi (vite)		Ndryshim afati norme (vite)	
				është bërhet		hiqet	shtohet
1.	Rrip pantallonash	copë	1	1	2		
2.	Çizme gome	palë	1	2	-	2	-
3.	Kanatjere pambuku	copë	2	1	-	1	
4.	Bluzë trikotazhi	copë	2	-	2	-	2

Në shënimet për normën nr. 6 bëhen këto rregullime:

1. Pika 1 riformulohet: materialet e veshmbathjes, afati i përdorimit të të cilave përputhet me kohën e shërbimit ushtarak të efektivit, trajtohen si materiale pronë veti dhe shkarkohen nga llogaria materiale pas plotësimit të afateve të përdorimit. Administrimi i këtyre materialeve, gjatë kohës së shërbimit ushtarak bëhet edhe me kartelë personale.

2. Pika 8 riformulohet: Reparteve u lejohej të mbajnë gjendje si material inventar reparti doreza të bardha për truporin e nderit, për t'u përdorur në raste ceremonish, me afat përdorimi 1 palë në 5 vjet dhe çizme gome deri 30% të efektivit me afat përdorimi 1 palë në dy vjet.

3. Shtohet pika 10: Me këtë normë furnizohen edhe ushtarët rrogëtarë me ndryshim që:

- Afati i përdorimit për xhupin me veshje të ngrohtë është 2 vjet , rripin e mesit 3 vjet, rripin e pantallonave 3 vjet, pandofla 2 vjet, lugë gjelle 2 vjet.

- Ushtarët rrogëtarë që merren në shërbim për herë të parë, fillimisht furnizohen vetëm me një kostum stërvitjeje veror ose dimëror, sipas stinës, këpucë stërvitjeje dhe rrip mesi e pantallonash. Pjesët e tjera të uniformës u jepen pasi të jenë marrë në provë. Ushtarët rrogëtarë që largohen vetë nga puna të çdëmtojnë vleftën e mbetur të veshmbathjes që është furnizuar.

- Pikat e tjera të shërbimeve për ushtarët aktive janë të barazvlefshme edhe për ushtarët rrogëtarë.

PASQYRA 8
NDRYSHIMET NË NORMËN NR. 8 TË VESHMBATHJES PËR OFICERËT E USHTARËT
REZERVISTË

Nr	Emërtimi i materialit	Njësia e matjes	Sasia	Ndryshim afati përdorimi (vite)		Ndryshim afati norme (vite)	
				është bërhet		hiqet	shtohet
1.	Pece këmbësh (çorape)	palë	2	15	6		
2.	Kokore, supore plastike	copë	1	10	-	10	

Në shënimet për normën nr. 8 bëhen këto rregullime:

1. Pika 1 riformulohet: Kostumi i stërvitjes dimëror dhe çizmet e gomës, pavarësisht nga afati i përdorimit, të qëndrojnë në ruajtje pranë BFU-ve ose depove të njëjësive të varësisë së Komandave të Forcave e Reparteve të varësisë së Shtabit të Përgjithshëm dhe të përdoren vetëm për kohë të veçantë e në raste të stërvitjeve të ndryshme në kushtet e temperaturave të ulëta, me urdhër të veçantë të Ministrit të Mbrojtjes. Gjithashtu, Ministri i Mbrojtjes autorizohet që, në rastet e stërvitjeve të vështira në kohë dimri në rajone të ftohta, ushtarakëve rezervistë t'u japë veshje suplementare të ngrohta nga rezervat e ushtrisë.

2. Të brendshmet e dimrit dhe pecet fanellatë (çorapet) të qëndrojnë gjendje në Pikat e Hapjes e të përdoren vetëm në kohë të veçantë me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

3. Kuadrot rezervistë, pjesëmarrës në kurset e kualifikimit ushtarak, furnizohen me materiale veshmbathjeje të normës përkatëse që kanë në ruajtje në Pikat e Hapjes.

EFEKTI EKONOMIK PËR NORMËN NR. 1 PËR OFICERËT

Emërtimi imaterialit	Nj. mat.	Sasia	Propozohet				Çmimi për njësi	Vlefata e amort. vjetor	Efekti ekonomik				Vërejtje
			Ndryshim afati		Ndryshim norme				Për person		Në total		
			Është vjet	Bëhet vjet	Hiqet nga norma vjet	Shtohet në normë vjet			Më shumë +	Më pak -	Më shumë +	Më pak -	
Xhup me veshje të ngrohtë	copë	1	5	4			3550	690	690		966000		Sh.Br.lartë
Rrip mezi për of. Shtabi br. e lartë	copë	1	3	5			260	87		174		243600	Sh.Br.lartë
Rrip mezi për kom. bat. e poshtë	copë	1	2	3			260	130		130		325000	K.bat.poshtë
Kostum stërvitje dimri shtab br. lartë	komp.	1	4	2			5041	1260	2525		3535000		Sh.Br.lartë
Kostum stërvitje dimri kom. bat. poshtë	komp.	1	2	1			5041	2520	2520		6300000		K.bat.poshtë
Kostum stërvitje vere shtab br. lartë	komp.	1	3	2			5041	1680	1680		2352000		Sh.Br.lartë
Çizme gome kom. bat. poshtë	palë	1	2	3			500	250		250		625000	K.bat.poshtë
Çizme gome sht. br.	palë	1	4		4		500			500		700000	Sh.Br.lartë
Çantë dokumentash	copë	1	6		6		300			300		1170000	
Doreza meshini me gëzof	palë	1	5	8			500	100		300		1170000	
Pulovër	copë	1	2	3			2500	1250		1250		4875000	
Bluzë trikotazhi	copë	2				2	500		500		1950000		
											15103000	9108600	

EFEKTI EKONOMIK PËR NORMËN NR. 2 PËR NËNOFICERË

Emërtimi imaterialit	Nj. mat.	Sasia	Propozohet				Çmimi për njësi	Vlefte e amort.	Efekti ekonomik				Vërejtje
			Ndryshim afati		Ndryshim norme				Për person		Në total		
			Është vjet	Bëhet vjet	Hiqet nga norma	Shtohet në normë			Më shumë +	Më pak -	Më shumë +	Më pak -	
Xhup me veshje të ngrohtë	copë	1	5	4			3450	690	690		2967000		
Bluzë trikotazhi	copë	2		2		2	500				2150000		
Rrip mezi për n/of. karrierës	copë	1	2	3			400	200	500	600		2580000	
Rrip mezi për n/of. të tjerë	komp.	1	2	5			400	80		400			
Pulovër	copë	1	2	3			2500	1250		1250		5375000	
Kostum stërvitjeje dimri	komp.	1	6	3			5041	840			7056000		n/of. tjerë
Kostum stërvitjeje dimri	komp.	1	2	1			5041	2520	2520		3780000		n/of. karriere
Kostum stërvitjeje vere	komp.	1	4	3			5041	1260	2520		3528000		n/of. tjerë
Çizme gome	palë	1	5		5		500		1260	500		1400000	n/of. tjerë
Çizme gome	palë	1	2	3			500			250		375000	n/of. karriere
Çantë dokumentash	copë	1	5		5		300			300		1290000	
Doreza meshini me gëzof	palë	1	5	8			500			300		1290000	
Pelerinë shiu	copë	1	2	3			3000			1500		6450000	
Këpucë stërvitje me qafë	palë	1	4	3			3000	750	750		3225000		
											22706000	18760000	

EFEKTI EKONOMIK PËR NORMËN NR. 3 PËR OFICERËT E NËNOFICERËT E POLICISË USHTARAKE

Emërtimi imaterialit	Nj. mat.	Sasia	Propozohet				Çmimi për njësi	Vlefte e amort.	Efekti ekonomik				Vërejtje
			Ndryshim afati		Ndryshim norme				Për person		Në total		
			Është vjet	Bëhet vjet	Hiqet nga norma	Shtohet në normë			Më shumë +	Më pak -	Më shumë +	Më pak -	
Pardesy	komp.	1	4	3			7270	2423			726900		
Kostum pune terital	komp.	1	3	2			11210	3736	3736		1120800		
Pulovër	copë	1	2	3			2500	1250		1250		375000	
Kostum stërvitjeje dimri	komp.	1	8	2			5041	630	3780		1134000		
Kostum stërvitjeje vere	komp.	1	6	1			5041	840	4200		1260000		

Këpucë stërvitje me qafë	palë	1	6	1			6000	500	2500		75000		
Çantë krahëqafë	copë	1		6		6	500		500		150000		
Doreza meshini me gëzof	palë	1	4	8			500	125		500		150000	
Bluzë trikotazhi	copë	2		2		2	500		500		150000		
Çizme gome	palë	1		3		3	500	167	167		50000		
											4666700	525000	

**EFEKTI EKONOMIK PËR NORMËN NR. 4 PËR NËNOFICERËT KARRIERËS SË
AKADEMISE SE KAPTERRAVE**

Emërtimi imaterialit	Nj. mat.	Sasia	Propozohet				Çmimi për njësi	Vlefte e amort.	Efekti ekonomik				Vërejtje
			Ndryshim afati		Ndryshim norme				Për person		Në total		
			Është vjet	Bëhet vjet	Hiqet nga norma	Shtohet në normë			Më shumë +	Më pak -	Më shumë +	Më pak -	
Xhup me veshje të ngrohtë	copë	1	2	3			3450	1729		1729		172900	
Mushama shiu	copë	1	2	3			3000	1500		1500		150000	
Çizme gome	palë	1	2	3			500	250		500		50000	
Çantë krahëqafë	copë	1	4	6			500	129		258		25800	
Çantë shpine	copë	1	4	5			200	50		50		5000	
Doreza meshini me gëzofë	palë	1	5	8			500	125		500		50000	
Lugë gjelle	copë	1	1	2			50			50		5000	
Bluzë trokitazhi	copë	2		2		2	500		500		5000		
Pulovër	copë	1	2	3			2000	830		830		83000	
											5000	541700	

EFEKTI EKONOMIK PËR NORMËN NR. 5 PËR STUDENTET E AKADEMIVE USHTARAKE

Emërtimi imaterialit	Nj. mat.	Sasia	Propozohet				Çmimi për njësi	Vlefte e amort.	Efekti ekonomik				Vërejtje
			Ndryshim afati		Ndryshim norme				Për person		Në total		
			Është vjet	Bëhet vjet	Hiqet nga norma	Shtohet në normë			Më shumë +	Më pak -	Më shumë +	Më pak -	
Bluzë trikotazhi	copë	3		3		3	500	333	1000		4000000		
Rrip pantallonash	copë	1	2	3			300	150		150		60000	
Çizme gome	palë	1	2	3			500	167		500		20000	
											4000000	80000	

EFEKTI EKONOMIK PËR NORMËN NR. 6 PËR USHTARËT

Emërtimi imaterialit	Nj. mat.	Sasia	Propozohet				Çmimi për njësi	Vlefte e amort.	Efekti ekonomik				Vërejtje
			Ndryshim afati		Ndryshim norme				Për person		Në total		
			Është vjet	Bëhet vjet	Hiqet nga norma	Shtohet në normë			Më shumë +	Më pak -	Më shumë +	Më pak -	
Rrip pantallonash	copë	1	1	2			300		300		2400000		
Çizme gome	palë	1	1		2		500		500		4000000		
Kanatjere	copë	2			2		150		300		2400000		
Bluza vere kamuflazhi	copë	2				2	500	500		4000000			
										4000000	8800000		

EFEKTI EKONOMIK PËR NORMËN NR. 7 PËR USHTARËT DHE OFICERËT REZERVISTË

Emërtimi imaterialit	Nj. mat.	Sasia	Propozohet				Çmimi për njësi	Vlefte e amort.	Efekti ekonomik				Vërejtje
			Ndryshim afati		Ndryshim norme				Për person		Në total		
			Është vjet	Bëhet vjet	Hiqet nga norma	Shtohet në normë			Më shumë +	Më pak -	Më shumë +	Më pak -	
Pece këmbësh (çorape)	palë	1	15	6			60	4	36	2880000	2880000		
Kokore e supore	copë	1	10		10		400		400	400	3200000		
											2880000	3200000	

**TABELA 8
EFEKTI I PËRGJITHSHËM EKONOMIK PËR NDRYSHIMET
NË NORMAT E VESHMBATHJES**

Nr.	Normat përkatëse ku janë bërë ndryshimet	Norma Nr.	Efekti ekonomik në lekë	
			Më shumë +	Më pak -
1	Norma e veshmbathjes për oficerat	1	15103000	9108600
2	Norma nr.2 për n/oficerët aktivë	2	22706000	18760000
3	Norma e veshmbathjes për oficerët n/oficerët e Policisë Ushtarake	3	4666700	525000
4	Norma e veshmbathjes për n/oficerët e Akademisë së Kapterave	4	5000	325700
5	Norma e veshmbathjes për studentët e Akademisë "Skënderbej"	5	400000	80000
6	Norma e veshmbathjes për ushtarët	6	4000000	8800000
7	Norma e veshmbathjes për ushtarët e oficerët rezervist	8	2880000	32000000
8	Gjithsej		49760700	69599300
9	Diferenca më pak			19838300

PASQYRA 9
EFEKTET EKONOMIKE NGA PARASHIKIMI I TË DREJTAVE TË FURNIZIMIT NË DISA
ARTIKUJ, TË LINDURA ME VKM, NR.418, DATË 10.6.1996

	Emërtim i materialit	Njësia e matjes	Sasia	Afati i përdorimit	Parashkrimi i të drejtës (vjet)	Amortizimi vjetor	Efekti ekonomik (më pak)	
							Për person	Gjithsej
1	Xhup me veshje të ngrohtë a) për oficerët e shtabeve e n/oficerët e tjerë b) për komand.e batalioneve e poshtë e n/of. të karrierës	copë	1	5	3	690	2070	7038000
		copë	1	3	3	1150	3450	17595000
2	Kostum sportiv	palë	1	2	4	750	3000	25500000
3	Këpucë atletike	palë	1	1	4	1000	4000	34000000
4	Çorape pambuku	palë	4	1	4	280	1120	9520000
5	Pelerinë shiu a) për oficerët e shtabeve e n/oficerët e tjerë b) për komand. e batalioneve e poshtë e n/of. të karrierës	copë	1	4	4	500		6800000
		copë	1	2	4	500	2000	20400000
6	Vlefte gjithsej							120853000

Shënim:

Në këtë pasqyrë nuk janë llogaritur detyrimet e pjeshme në artikujt:

a) Kostum stërvitjeje dimëror e veror kamuflazhi, hedhja në përdorim e të cilëve është bërë gjatë viteve 1998-2000 por që kuadrot pjesërisht janë furnizuar me kostume leshi e doku të modelit të vjetër si dhe nga ndihmat.

b) Këpucë stërvitjeje me qafa, çizme gome, pajime etj. Për rrjedhojë efekti ekonomik në ulje është më shumë se 120853000 lekë.

V E N D I M
Nr.277, datë 8.5.2001

PËR DHËNIE FOND NDIHME PARTISË DEMOKRATE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 dhe 22 të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 "Për partitë politike" dhe të ligjit nr.8718, datë 19.12.2000 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2001", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Partisë Demokratë t'i jepet një fond 1 100 000 (një milion e njëqind mijë) lekësh, përkatësisht për:

- 100 000 (njëqind mijë) si ndihmë financiare në çastin e krijimit të saj;
 - 1 000 000 (një milion) për pagesën e qirasë së zyrave, qendrore e vendore.
2. Ky fond të përballohet nga fondet buxhetore të vitit 2001 për partitë politike.
3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

U D H Ë Z I M

Nr.34, datë 12.5.2001

PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NË FORCAT E ARMATOSURA DHE NË FORCAT E RENDIT

Për realizimin e të drejtës së votës të zgjedhësve në Forcat e Armatosura dhe në Forcat e Rendit për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë të 24 qershorit 2001, në mbështetje të nenit 60 dhe 104 pika 1 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Komisioni Qendor i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

Ministria e Mbrojtjes dhe Minsitria e Rendit Publik, përmes komandave të njësisve e reparteve në vartësi, organizojnë punën për hartimin e listës së zgjedhësve që në datën e zgjedhjeve do të ndodhet në repartin përkatës, sipas formularit bashkëlidhur.

Për realizimin e këtij detyrimi ligjor do të procedohet:

1. Oficerët dhe nënoficerët që janë të punësuar, si rregull, regjistrohen dhe votojnë si gjithë shtetasit e tjerë në vendbanimin e përhershëm të tyre, së bashku me familjen. Për këtë kategori votuesish, komanda përkatëse harton grafikun e shërbimit në mënyrë që, krahas kryerjes së detyrës funksionale, t'u krijojë mundësi për të ushtuar të drejtën e votës, brenda orës 8.00 deri 18.00 të ditës së votimit.

2. Ushtarët e shërbimit të detyrueshëm, si dhe oficerët apo nënoficerët e karrierës që banojnë në repart (që janë me vendqëndrim) dhe në ditën e zgjedhjeve do të jenë në repart regjistrohen në listën e zgjedhësve të repartit, duke plotësuar për çdo zgjedhës me germa kapitale, saktësisht sipas të dhënave të certifikatës së lindjes, gjithë të dhënat që kërkon modeli i listës, që shoqëron këtë udhëzim.

Lista firmoset dhe vuloset veças në çdo faqe nga komandanti i repartit dhe shefi i personelit dhe, brenda datës 22.5.2001 ora 12.00 me një shkresë përcjellëse, në të cilën përcaktohet edhe numri i përgjithshëm i votuesve në listë, dorëzohet në Komisionin e Zgjedhjeve të Qeverisjes Vendore të bashkisë apo komunës, brenda territorit të së cilës ka vendndodhjen repartit, nga shefi i personelit të repartit, kundrejt një procesverbali, firmosur nga kryetari, zevëndëskryetari dhe sekretari i KZQV-së.

3. Kryetari, zevëndëskryetari dhe sekretari i KZQV-së, marrin kontakt me kryetarin e bashkisë apo komunës dhe, së bashku, përcaktojnë qendrën e votimit që është më afër repartit dhe ku do të votojnë zgjedhësit e listës përkatëse.

Numri i qendrës së votimit shënohet në krye të çdo faqeje të listës së ardhur nga repartit dhe, përkrah saj, vendoset vula e KZQV-së.

4. KZQV-ja, listën e repartit, brenda datës 25.05.2001 ora 12.00, e dorëzon doras me proceverbal tek supervizori i KQZ-së në prefekturën përkatëse, i cili, në datën 26.5.2001, e dorëzon ne Drejtorinë e Regjistrit Kombëtar te Zgjedhësve.

5. Drejtoria e Regjistrit Kombëtar të Zgjedhësve, këta zgjedhës i përfshin në listën përfundimtare të KZZ-së ku ka vendndodhjen reparti dhe i heq nga listat e zgjedhësve të vendbanimit përkatës.

6. Komandat e reparteve duhet t'i bëjnë të qartë dhe t'i krijojnë mundësi çdo zgjedhësi të përfshirë në këto lista, që, ditën e votimit, do të lejohen të votojnë, vetëm nëse do të paraqesin në komisionin e qendrës së votimit një nga këto dokumente: certifikatë lindjeje me fotografi, letër njoftimi, pasaportë për jashtë shtetit, kartën e votuesit, si dhe librezë ushtarake.

Ditën e zgjedhjeve, në orën 7.30, komanda e repartit dorëzon në KQV edhe një listë të zgjedhësve ushtarë.

7. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I
Ilirian Celibashi

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 15.5.2001
Doli nga shtypi më 18.5.2001

Tirazhi: 41 00 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja “At Gjergj Fishta”, Tiranë

Çmimi: 200 lekë